

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Mbrojtja

Viti i 90-të i botimit
Gusht 2022/ Nr. 8

**Bajram Begaj
betohet në Kuvend si
President i Republikës**



**Presidenti Begaj: Do të jem shërbëtor i popullit tim, përfaqësues i unitetit
tonë kombëtar, mbështetës i palëkundur i rrugëtimit euroatlantik**

Përmbajtja

Numri 8

NATO

- 8** Kryeministri Rama: Shqipëria, krenare për rolin e saj për paqen dhe stabilitetin

ZHVILLOHET CEREMONIA KPO 2022

- 10** Ministri Peleshi: Në emër të popullit shqiptar, familjarëve tuaj, iu dërgoj një falënderim dhe iu përulëm për edukimin e tyre, të këtij brezi ushtarakësh kaq të rëndësishëm për Shqipërinë

SHTABI I PËRGJITHSHËM

- 13** Gjeneralmajor Manushaqe Shehu merr pjesë në ceremoninë e ndërrimit të komandantit të Komandës Supreme të Aleatëve në Europë

PORTRET

- 34** KOLONEL HALIL KATANA, ushtaraku, gazetari dhe qytetari me gjurmë të arta në panteonin e vlerave të FA-së

SHKENCË

- 42** Besimi në informacionin e rremë është një shqetësim i shëndetit mendor

STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të Botimeve
& Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza GOLIKJA

Graphic Designer:
Afërdita HYSAJ

Redaktore/ korrektore:
Suela HODA



4 BETIMI

Presidenti Begaj: Do të jem shërbëtor i popullit tim, përfaqësues i unitetit tonë kombëtar, mbështetës i palëkundur i rrugëtimit euroatlantik

Presidenti i ri i Shqipërisë, z. Bajram Begaj mori zyrtarisht detyrën, pas betimit në Kuvendin e Shqipërisë dhe ceremonisë në Presidencë. Pas betimit mbi Kushtetutën e Shqipërisë...

6 SHQIPËRIA CELI NEGOCIATAT PËR ANËTARËSIM ME BE-NË

Rama: Falënderoj popullin shqiptar për mosdorëzimin në ndjekjen e rrugës europiane

16 vite pas firmosjes së marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, Shqipëria, në ditën historike të 19.7.2022, çel negociatat për anëtarësim me Bashkimin...

8 MINISTRI PELESHI

"Shqipëria, pjesë e trupave në krahun lindor të Aleancës, tashmë me kontribut edhe në Bullgari"

Aktivizohet në Shqipëri Brigada e Asistencës së Forcave të Sigurisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SFAB), një ekip i cili do të mbështesë dhe këshillojë Batalionin e Dytë të...

48 100-vjetori i vendosjes së marrëdhënieve mes Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë

Historia njëshekullore me botën e kombeve të lira

Data 28 korrik 2022, shënon 100-vjetorin e njohjes së Shqipërisë nga SHBA-të dhe vendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Marrëdhënie këto që pas atij lulëzimi do të...

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

Mbrojtja



Botues:

Qendra e Kulturës, Medias,
Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe
Botimeve të Mbrojtjes

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror
i Ministrisë së Mbrojtjes
Viti i 90-të i botimit
Nr. 8/ 2022

© Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë
revistë nuk mund të riprodhohen
elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfitimi, pa
marrë autorizim nga botuesit e saj.

**Revista mund të gjendet në formatin
elektronik (pdf) në adresën:**

[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/
publikime/revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)





Bajram Begaj betohet në Kuvend si President i Republikës

**Presidenti Begaj: Do të jem shërbëtor i popullit tim,
përfaqësues i unitetit tonë kombëtar, mbështetës
i palëkundur i rrugëtimit euroatlantik**

Presidenti i ri i Shqipërisë, z. Bajram Begaj mori zyrtarisht detyrën, pas betimit në Kuvendin e Shqipërisë dhe ceremonisë në Presidencë.

Pas betimit mbi Kushtetutën e Shqipërisë, Begaj mbajti një fjalë përshëndetëse në Kuvend, ku theksoi se përgjegjësia që ai merr vjen në një moment historik për Shqipërinë e cila “ka hyrë në një rrugë të pakthyeshme europiane”.

“U betova sot se do t’i shërbej Kushtetutës, interesit kombëtar dhe përparimit të popullit shqiptar dhe të përmbush detyrën time sipas parimeve dhe normave të kushtetutës. Këtë mision do ta kryej mbi palët, por unë nuk do të qëndroj neutral ndaj asnjërit që bie ndesh me këtë betim, ndaj asnjërit që vendos interesat personale përpara intereseve të kombit tonë”, - tha Begaj.

Ai shtoi se do të mbështesë bashkëpunimin mes të gjitha forcave politike, në gjetjen e gjuhës së përbashkët dhe se angazhimi i të gjithëve është “të kemi ndjenjën e përgjegjësisë dhe të respektojmë vendimet e organeve kompetente”.

Pas betimit, Begaj u drejtua drejt selisë së Presidencës së Shqipërisë, ku iu dorëzua detyra nga ish-presidenti Ilir Meta.

Pasi kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, Vitore Tusha, i dorëzoi Presidentit Begaj Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, presidenti i ri i vendit mbajti një fjalë përshëndetëse, ku theksoi se do të jetë përfaqësues i unitetit kombëtar.

“Sot u betova për besnikëri ndaj Kushtetutës e ligjeve të vendit, për të respektuar të drejtat dhe liritë e shtetasve, për të mbrojtur pavarësinë e Republikës së Shqipërisë dhe për t’i shërbyer interesit të përgjithshëm dhe përparimit të popullit shqiptar”, - tha presidenti Begaj.

Presidenti Begaj shtoi më tej: “Do të jem shërbëtor i popullit tim, përfaqësues i unitetit tonë kombëtar, mbështetës i palëkundur i rrugëtimit euroatlantik për të gjithë shqiptarët e Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, Luginës së Preshevës dhe kudo që ata jetojnë e punojnë”.



Urimi i ministrit të Mbrojtjes, Niko Peleshi, drejtuar presidentit Bajram Begaj

“**S**uksese Bajram Begajt në detyrën e Kreut të Shtetit! I bindur se do të kemi një bashkëpunim të shkëlqyer edhe si Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura!” - do të uronte Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi në ditën e dekretimit të kreut të shtetit shqiptar, presidentit Bajram Begaj.



Shqipëria çeli negociatat për anëtarësim me BE-në



Rama: Falënderoj popullin shqiptar për mosdorëzimin në ndjekjen e rrugës europiane

16 vite pas firmosjes së marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, Shqipëria, në ditën historike të 19.7.2022, çel negociatat për anëtarësim me Bashkimin Europian. Në konferencën e parë ndërqeveritare, mbajtur në Bruksel, kreu i qeverisë Edi Rama e konsideroi anëtarësimin në BE, një çështje për "jetë a vdekje", ndërsa u shpreh se vendi do të vijojë në përmbushjen e sfidave.

"Ia dolëm të dëshmojmë se ishim më të mirë e më të fortë. Nuk ka të bëjë vetëm për ne, bëhet fjalë për të ardhmen europiane. BE ka qenë më shumë se sa raporte apo shkresa. Edhe pse u shtynë padrejtësisht për tre vite, ne vijuan edhe me më

shumë këmbëngulje.

Sot Shqipëria është vendi më i avancuar në rajon. Shkatërruam pallatin e vjetër të drejtësisë së korruptuar. SPAK dhe BKH janë thelbësor në këtë epokë të re. Nëse pak vite më parë, mund të kishit pyetur dikë për një politikan pas hekurave, do kishin qeshur me ju. Sot askush nuk ka imunitet. Barazia përballë drejtësisë është e mundshme dhe e arritshme.

Qëndroj këtu si lider i një maxhorance, të zgjedhur në mënyrë demokratike, që nuk ka mbrojtur askënd nga drejtësia. Sigurisht shumë hije të së shkuarës vijnë, kjo është arsyeja pse jemi këtu.

I bashkohemi SHBA-ve si penëmbajtëse për luftën në Ukrainë, do vijojmë të luajmë rol kyç në konfig-



urimin e ri gjeopolitik. Ndjekim një rrugë konsistente me BE-në nga viti 2014, mbi politikën e jashtme. Iniciuam nismën Ballkanike të quajtur "Open Balkan".

Dua të kujtoj se nuk do jenë vetëm 2 por 4 nga 6 shtete të Ballkanit. Në një zonë si Ballkani, do të thotë më pak fantazma nga historia në jetën tonë politike. Duke qenë 4 vende për t'u bashkuar me BE-në, përgjysmohet fryma e ndarjes. Pavarësisht zhgënjimeve, BE nuk është një projekt që do të përfundojë një ditë. Ndiurma pas tërmetit, gjatë pandemisë, investimet, kanë luajtur një rol për vendin tonë. Pozicioni ynë ekonomik të jetë në përpjesëtim me shtetet anëtare të BE.

Do angazhohemi në planet e veprimit të transportit dhe për të zgjeruar korsitë e gjelbra. Do investojmë në ndërlidhjen kombëtare dhe rajonale. Nga ana tjetër duam të bëhemi kampion rajonalë të epokës dixhitale. Tek flasim po luftojmë ndaj një sulmi kibernetik, nga një vend armiqësor me BE-në, por sistemi ynë po reziston. Ne jo vetëm do vijojmë të raportojmë periodikisht, por do gjejmë mënyra për të rritur cilësinë.

Në të njëjtën kohë do punojmë për sfidat dhe mundësitë për anëtarësimin në BE. Ndërsa ne festojmë me entuziazëm sot, nuk kemi qenë kurrë më të vetëdijshëm për sfidat. Shumë europianë duhet ta kuptojnë se BE ka nevojë për Ballkanin po aq sa Ballkani ka për BE-në. Shumë që nuk kuptojnë çfarë e motivoi projektin duhet ta shohin tani. Ka nevojë për një Europë të rinovuar. Po, është një luftë e vazhdueshme: Vetë lufta drejt lartësive mjafton për të mbushur zemrën e njeriut." - u shpreh Rama.

Ndërsa në fjalën e tij falënderuese Rama, shprehu mirënjohjen për ekipin e Presidentit Macron, dhe kontributin e dhënë në zhbllokimin e ngërçit mes Maqedonisë së Veriut dhe Bullgarisë.

"Dua të falënderoj një tjetër zonjë gjermane që nuk është më aktive, por pa të cilën nuk do të ishim këtu dhe kjo është ish-kancelarja Angela Merkel. Ajo ka ditëlindjen dhe do të doja t'i uroja gjithë të mirat.

Rama falënderoi dhe popullin shqiptar, për mosdorëzimin në ndjekjen e rrugës europiane



Nga ana e saj Presidentja e Komisionit European, Von der Leyen, e cilësoi një moment historik çeljen e negociatave për Shqipërinë. Ajo vlerësoi gjithashtu kryeministrin Edi Rama për punën e shkëlqyer gjatë 3 mandateve qeverisje.

"Ky është një moment historik, sot Shqipëria ka hapur negociatat për aderimin në BE dhe jam shumë e lumtur që jam këtu me ju. Ky është suksesi juaj, i juaji si qeveri dhe i qytetarëve tuaj. Keni punuar kaq shumë për të arritur deri këtu.

Ju keni bërë ndryshim, jo vetëm aty ku janë të detyrueshme për rrugën drejt BE-së, por sepse janë të mira për vendin tuaj.

Këto reforma po japin një cilësi më të mirë jetese. Ne si KE ju kemi mbështetur dhe do të vazhdojmë ta bëjmë. I dashur Edi, ju keni treguar kaq shumë lidhshmëri, vizion, durim strategjik me sasi të mëdha. Populli shqiptar e meriton dhe ne të gjithë do të jemi bashkë kur do të presim Shqipërinë si të barabartë në BE", - tha presidentja e BE-së.

Kryeministri Rama: Shqipëria, krenare për rolin e saj për paqen dhe stabilitetin

NATO, bazë
detare në
Durrës, Rama
i paraqet
propozimin
Sekretarit të
Përgjithshëm
Stoltenberg

denë e tij për vendosjen e një baze ushtarake të NATO-s në portin e ri të Durrësit, kryeministri Rama ia prezantoi dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Aleancës, Jens Stoltenberg, me të cilin zhvilloi një takim zyrtar në Bruksel.

Në konferencën për mediat me Stoltenberg, kryeministri Rama tha se Shqipëria është krenare për rolin e saj në rajon.

"Është kënaqësi e madhe dhe po kështu një nder që kthehem këtu dhe që kam mundësinë të ndaj me ju disa opinione pas samitit të Madridit, i cili, siç e theksuat, ishte vërtetë një moment historik për Aleancën Transatlantike në përgjigje ndaj rreziqeve të sigurisë europiane për shkak të luftës së qëllim të Rusisë e po kështu dhe me miratimin e vendimeve të rëndësishme për të transformuar dhe forcuar Aleancën dhe për të siguruar që NATO të vijojë të mbrojë paqen dhe të parandalojë konfliktin e të mbrojë popujt dhe vlerat e Aleancës.

Nga ana tjetër, jam krenar që Parlamenti Shqiptar u bë një prej parlamenteve të para të vendeve aleate për të ratifikuar protokollet e anëtarësimit të Finlandës dhe Suedisë, vetëm pak ditë pas nënshkrimit të tyre nga ambasadorët e vendeve aleate. Ne qëndrojmë me forcë në solidaritet të plotë me Ukrainën

dhe sigurisht që është e padiskutueshme mbështetja jonë për sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës, brenda kufijve të njohur ndërkombëtarisht, mbështetje që është më e palëkundur se kurrë.

Nga ana tjetër, është e rëndësishme që ne të vazhdojmë bashkëbisedimin tonë përkundrejt situatës dhe po kështu edhe detyrimet që ne kemi në Ballkanin Perëndimor, që pikërisht të parandalojmë çdo përshkallëzim e të parandalojmë që çdo ndikim i keq të kthehet në problem për rajonin tonë. Në kapacitetin tonë si vend aleat dhe si vend kandidat për në BE, ne do vazhdojmë të luajmë rolin tonë tradicional, në mbështetje të paqes rajonale, pajtimit dhe sigurisht, stabilitetit.

Ndërkohë që koncepti i ri strategjik që sapo kemi miratuar thekson rolin strategjik të Ballkanit Perëndimor për NATO-n, ne besojmë shumë se është tejet e rëndësishme që të vijojmë një dialog të përhershëm me të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Serbinë, e cila nuk është pjesë e aleancës sonë, por ende është pjesë e rajonit tonë.

Nga ana tjetër, pata dhe njëherë shansin t'ju them atë që kam përmendur tashmë në Samit. Nevojën për të konsideruar përfshirjen e Kosovës në partneritetin për paqe edhe pse e dimë që ka disa kufizime politike nga disa aleatë dhe e dimë që ky është organizëm konsensual. Megjithatë, në kohët ku jetojmë, në këndvështrimin tim modest, është vërtetë e mençur që kjo të ri konsiderohet. Së fundmi në radhë, por jo nga rëndësia, e vlerësoj shumë disponibilitetin tuaj për të na kushtuar pak kohë në bisedën tonë për t'ju prezantuar ambicien tonë, për të shtuar një vlerë tjetër të rëndësishme në infrastrukturën dhe logjistikën e aleancës sonë, duke vënë në dispozicion të NATO-s një bazë të flotës detare të fjalës së fundit që do të jetë një vend që jo vetëm mund të ndërtojmë, por mund ta ndërtojmë duke pasur parasysh sfidat e kohës sonë, nga ndryshimi i klimës, nga mbrojtja e mjedisit e gjithçka tjetër. Faleminderit shumë edhe për këtë dhe është përherë kënaqësi të kthehesh këtu dhe është gjithnjë e dobishme të kthehesh me energji të plota e të vazhdosh t'i shërbesh kësaj aleance të shenjtë", -tha Rama.



Ministri Peleshi: Shqipëria, pjesë e trupave në krahun lindor të Aleancës, tashmë me kontribut edhe në Bullgari

Aktivizohet në Shqipëri Brigada e Asistencës së Forcave të Sigurisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SFAB), një ekip i cili do të mbështesë dhe këshillojë Batalionin e Dytë të Këmbësorisë së Forcës Tokësore. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, në prani edhe të ministrit të Mbrojtjes Niko Peleshi dhe ambasadores së SHBA-ve në Shqipëri, znj. Yuri Kim, u theksua rëndësia e ndërveprueshmërisë mes aleatëve të NATO-s në një terren të ri për sigurinë botërore. Në fjalën e tij, ministri Peleshi vlerësoi mbështetjen dhe ndihmën e vazhdueshme që SHBA-të kanë dhënë për Forcat e Armatosura. "Ky grup-batalion është objektivi ynë kryesor në NATO dhe jemi duke punuar intensivisht për të bërë të mundur realizimin e të gjitha detyrimeve në këtë kuadër dhe padyshim asistencë e ekipit amerikan është e një rëndësie të veçantë. Jam i bindur që puna juaj do të japë frytet e saj dhe do të kurorëzohet me certifikimin e suksesshëm që kjo strukturë do t'i nënshtrohet gjatë muajit shtator të këtij viti", - u shpreh ministri i Mbrojtjes.

Duke theksuar vendimet tejet të rëndësishme që u morën në Samitin e NATO-s në Madrid si dhe miratimin e Konceptit të ri Strategjik të Aleancës, ministri Peleshi garantoj forcimin e angazhimit të Shqipërisë përkrah aleatëve të saj ushtarakë. "Shqipëria, jo vetëm që do të vijojë të jetë pjesë e trupave në krahun lindor të Aleancës me prezencën tonë në Letoni, por do të shtojë kontributin edhe në Bullgari, në kuadër të grup-batalioneve të reja, që do të krijohen në disa prej vendeve anëtare të Aleancës. Ne do të vijojmë të përmbushim me seriozitet dhe profesionalizëm detyrimet në Aleancë dhe detyra juaj, të nderuar ushtarakë, është të shfrytëzoni në maksimum këtë mundësi që ju jepet për të rritur dhe më tej standardet operacionale në mënyrë që të jeni të ndërveprueshëm me homologët tuaj", - theksoi ministri Peleshi.

Në fjalën e saj, ambasadorja amerikane Yuri Kim e vlerësoi aktivizimin e Brigadës së Forcave të Sigurisë dhe të ndihmës së ushtrisë së SHBA-ve si një hap të rëndësishëm për të çuar në lartësi të reja marrëdhëniet SHBA-



Shqipëri. "Është e rëndësishme që ju të përmbushni të gjitha objektivat tuaja që u diskutuan edhe në Samitin e NATO-s. Bota ka ndryshuar, ka sfida të reja, të cilat duhet të përmbushen. Çdo aleat duhet të jetë i gatshëm, i përgatitur dhe për këtë arsye jemi të kënaqur për forcën e sotme në mënyrë që të jemi të gatshëm, që NATO të jetë e gatshme. Nën drejtimin e ministrit Peleshi dhe gjeneral brigade Kingjit forcat shqiptare vazhdojnë të përmirësohen përmes modernizimit, zhvillimit të infrastrukturës dhe ndryshimeve strukturore që do të luajnë një rol të rëndësishëm,

jo vetëm për Shqipërinë, po për sigurinë rajonale dhe globale. Ndërveprueshmëria e aleatëve të NATO-s është vendimtare", - vlerësoi ambasadorja Kim.

Në ceremoni morën pjesë edhe zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së gjeneralmajor Manushaqe Shehu dhe komandanti i Forcës Tokësore Arben Kingji. Aktivizimi i ekipit të Brigadës së Asistencës së Forcave të Sigurisë së SHBA-ve në Shqipëri vjen pas aktivizimit në vendin tonë edhe të Shtabit Të Përpunuar të Forcave Speciale amerikane në Europë.





ZHVILLOHET CEREMONIA KPO 2022

Ministri Peleshi: Në emër të popullit shqiptar, familjarëve tuaj, iu dërgoj një falënderim dhe iu përulem për edukimin e tyre, të këtij brezi ushtarakësh kaq të rëndësishëm për Shqipërinë

Në ambientet e gar-nizonit ushtarak “Skendërbej” u organizua ceremonia e diplomimit të KPO 2022. Të pranishëm në ceremoni ishin ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, zëvendësministria e Mbrojtjes Dallë-ndyshe Bici, drejtori i Shtabit të Përgjithshëm Bilbil Bitri, atashe ushtarakë të akredituar në vendin tonë, gjeneralë, komandantë, drejtues të FA-së, si dhe familjarë të studentëve, të cilët kishin emocionin e fëmijëve

të tyre, të cilët tashmë do të jenë liderët e së ardhmes së afërt.

Komandant i AFA-së, gjeneral brigade Albert Mullai në fjalën e tij përshëndetëse me rastin e përfundimit të KPO 2022 theksoi: “Ju sfi-duat një program mjaft cilësor me standarde të larta bashkëkohore. Me kënaqësi ju them se ju ja dolët!”

Gjeneral Mullai falënderoi pedagogët, instruktorët, drejtuesit për punën intensive dhe profesionale. Një falënderim tjetër ishte për familjet e studentëve që i mbështetën në zgjedhjen e tyre,

për të qenë pjesë e Forcave të Armatosura.

“Me punë serioze dhe angazhim të palodhur krijuat kohezion duke arritur të jeni tashmë ushtarake me njohuri, aftësi dhe vlera, të gatshëm për të marrë përgjegjësi. Detyrat tuaja nesër do të jenë më të vështira dhe më komplekse dhe për këtë ju duhet të jeni gati. Ju tani e tutje nuk do jeni përgjegjës vetëm për veten tuaj por dhe për efektivet që do të drejtoni, ndaj punoni dhe përgatituni për të qenë liderët e së ardhmes.



Geveria dhe Ministria e Mbrojtjes i kanë kushtuar një rëndësi të madhe arsimimit në FA, duke na orientuar drejt arsimimit më të mirë në botë, atij të "WEST POINT"-it, - do të citonte në fjalën e tij komandanti i AFA-së gjeneral brigade Albert Mullai.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi në fjalën e tij të rastit, pasi përshëndeti të pranishmit dhe uroi studentët për përfundimin me sukses të këtij rrugëtimi të vështirë dhe plot sfida, u shpreh se: "ishte

i lumtur që Forcave të Armatosura i shtohen edhe 54 oficerë të rinj, ku 29 janë vajza dhe 25 djem, të arsimuar më parë në universitete civile, të cilët ndoqën për rreth 1

Armatosura." Më tej, ministri Peleshi do vijonte fjalën e tij: "Sot ju do të vendosni simbole të reja, çka do të thotë dhe përgjegjësi të reja, përgjegjësi ndaj atdheut,



vit Kursin e Përgatitjes së Oficerit dhe tashmë do të shërbejnë si oficerët më të rinj të FA-së.

Ata bëhen pjesë e kësaj armate në një moment kur Forcat e Armatosura, figura e ushtarakut në Shqipëri, në Europë dhe në gjithë botën ka marrë një vëmendje të veçantë. E gjithë shoqëria ka kthyer kokën, ka vendosur besimin dhe shpresën për një të nesërme më të mirë, më të paqte tek figura e ushtarakut, tek Forcat e

përgjegjësisë ndaj detyrës më të shenjtë dhe më të lartë që një qytetar mund të ketë në jetën e tij. Sot ju do titulloheni oficerë, ka disa arsye pse jeni ju dhe jo kushdo tjetër, sot oficer ju ka bërë kuraja dhe sakrifica individuale, por dhe përkushtimi i profesorëve dhe komandantëve tuaj, ndaj të cilëve ndiej mirënjohje dhe falënderim për gjithë punën e tyre të madhe. Jo të gjithë e kanë të thjeshtë të ndërmarrin një nismë të tillë, të vetë mohohen në raste të caktuara. Në emër të popullit shqiptar, gjithë familjarëve tuaj iu dërgoj një falënderim dhe iu përulëm për edukimin e tyre, të këtij brezi ushtarakësh kaq të rëndësishëm për Shqipërinë".





Deklaratë e zëvendësministres së Mbrojtjes, Dallëndyshe Bici

Sipas të dhënave më të fundit nga Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile, janë vënë nën kontroll 20 vatra zjarri, ku 10 prej tyre kanë qenë me problematike.

Janë shuar dy vatrat në qarkun e Vlorës, ajo në fshatin Qesarat dhe në kodrat me ulla të Pusit të Mezinit në qarkun e Vlorës.

Në qarkun e Durrësit është neutralizuar vatra në "Makaresh", zonën e Krastës, në fshatin Bizë për të cilën është luftuar prej dy ditësh, në varrezat e vjetra të Durrësit si dhe në Gjirin e Lalzit, duke shmangur rreziqet për zonat e banuara.

Më e qetë është situata edhe në një vatër në fshatin Patin në Klos. Është shuar një vatër e raportuar në Vorë në fshatin Marikaj dhe fshatin Dushk në bashkinë Lushnje.

Puna vijon në shpatin e malit në Balldren, ku situata është normalizuar, në fshatin Shetaj në Durrës, në fshatin Lgjin në Orosh të Mirditës, ku është aktivizuar sërish një vatër si dhe në fshatin Lekbibaj në Tropojë.

Gjatë dy muajve të sezonit të verës, qershor - korrik për shkak edhe të temperaturave të larta që kanë përfshirë të gjithë rajonin e Europës, në të gjithë vendin janë shfaqur 220 vatra zjarri në 42 bashki të

vendit.

Prefekturat të cilat kanë pasur numrin më të lartë të vatrave të zjarreve kanë qenë Fieri, Shkodra, Vloja dhe Tirana.

Në menaxhimin e situatave të zjarreve, gjatë kësaj periudhe janë angazhuar në total 3.088 forca dhe 320 mjete nga: Forcat e Armatosura, Forcat Zjarrfikëse, Policia e Shtetit, forca vullnetare, trupa të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Shërbimit Pyjor si dhe punonjës të pushtetit vendor.

Në dy operacione për shuarjen e zjarreve, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile i është drejtuar Mekanizimit Europian të Mbrojtjes Civile për ndihmë.

Të gjitha strukturat e sistemit të Mbrojtjes Civile janë në gatishmëri të plotë me të gjitha kapacitetet nga toka dhe ajri.

U bëjmë thirrje qytetarëve të cilësojnë veten pjesë të Mbrojtjes Civile, të bëjnë kujdes dhe të raportojnë në kohë zjarret, në mënyrë që të parandalohet përhapja e tyre në sipërfaqe më të mëdha. Bashkëpunoni me pushtetin vendor, njoftoni sa më shpejt të mundeni zjarrfikësit! Zjarret e qëllimshme, ose nga pakujdesia dënohen sipas ligjit.

Gjeneralmajor Manushaqe Shehu merr pjesë në ceremoninë e ndërrimit të komandantit të Komandës Supreme të Aleatëve në Europë

Zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-ve, gjeneralmajor Manushaqe Shehu mori pjesë në ceremoninë e dorëzimit dhe marrjes së detyrës së komandantit të Komandës Supreme të Aleatëve në Europë (SACEUR), Mons, Belgjikë. Gjeneral Tod Wolters (Forca Ajrore, SHBA) i dorëzoi detyrën gjeneral Christofer Cavoli-t.

Në këtë ceremoni mori pjesë edhe sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s vlerësoi maksimalisht leadershipin e gjeneral Wolters për udhëheqjen, drejtimin dhe komandimin me sukses të Komandës Strategjike të Aleancës për Operacionet në përmbushjen e misionit të Aleancës. Stoltenberg theksoi se gjeneral Wolters ka meritën e parandalimit që kriza shëndetësore e krijuar nga COVID - 19, të transformohej në krizë sigurie si dhe reagimin me shpejtësi dhe forcë ndaj agresionit brutal të Rusisë ndaj Ukrainës duke forcuar krahun lindor të Aleancës. Duke i uruar mirëseardhjen, Stoltenberg u shpreh se gjeneral Cavoli do shërbejë në NATO me të njëjtin leadership dhe përkushtim që ai ka treguar gjatë të gjithë karrierës së tij. Gjeneral Cavoli merr komandën në një kohë të rëndësishme për Aleancën, e cila shënohet me rritjen e konkurrencës strategjike dhe rikthimit të luftës brutale në Europë. Sekretari i Përgjithshëm u shpreh se gjeneral Cavoli me ekipin e tij në SHAPE do vijojë të përmbushë me sukses misionin e aleancës për mbrojtjen e hapësirës euro-atlantike.

Gjeneralmajor Shehu falënderoi gjeneralin Wolters për përmbushjen me sukses të detyrës, si dhe i uroi mirëseardhjen gjeneral Cavoli-t në detyrën e rëndësishme të Komandantit të Komandës Strategjike të Operacioneve të NATO-s. Gjeneralmajor Shehu në emër të FARSH e garantoi gjeneral Cavoli-n për forcim të bashkëpunimit, mbështetje dhe kontribut kudo dhe kurdo që aleanca do të ketë nevojë.

Komanda Supreme e Aleatëve në Europë (SACEUR) është përgjegjëse për planifikimin dhe ekzekutimin e të gjitha operacioneve të NATO-s. Gjenerali Cavoli është komandanti i njëzetë Suprem i Aleatëve në Europë (SACEUR). I pari që zuri postin ishte gjeneral Dwight D. Eisenhower, më pas presidenti i 34-t i Shteteve të Bashkuara.



Gjeneral brigade Bilbil Bitri priti në takim atasheun ushtarak bullgar, kolonel Momchil Ivanov

Drejtori i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bilbil Bitri, priti atasheun ushtarak të Bullgarisë në Tiranë, kolonel Momchil Ivanov, me rastin e përfundimit të detyrës.

Gjeneral brigade Bitri, pasi i uroi mirëseardhjen, vlerësoi kontributin dhe angazhimin e kolonel Ivanov në bashkëpunimin në fushën e Mbrojtjes mes Shqipërisë dhe Bullgarisë, bashkëpunim i cili është në rritje.

Përveçse në rrafshin dypalësh, bashkëpunimi me Bullgarinë zhvillohet edhe në kuadër të nismave rajonale dhe të Aleancës dhe roli i atasheut mbetet i rëndësishëm.

Njëherazi gjeneral brigade Bitri i uroi mirëseardhjen atasheut të ri të Bullgarisë në Tiranë, kolonel Miroslav Sandrev.

Gjatë takimit të dy bashkëbiseduesit shprehën besimin dhe dëshirën e vijimit dhe forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit ushtarak midis dy vendeve edhe në të ardhmen.



Ekipi i Akademisë "West Point", vizitë në Akademinë e Forcave të Armatosura

Në kuadër të riorganizimit dhe modernizimit të Akademisë së Forcave të Armatosura, sipas modelit të Akademisë Ushtarake të "West Point" të SHBA-ve, një grup pedagogësh nga Akademia Ushtarake e "West Point" zhvilloi një vizitë pune në Akademinë e Forcave të Armatosura.

Qëllimi i vizitës ishte diskutimi dhe përgatitja e draft-programeve mësimore (kurrikulave) për programet e ciklit Bachelor, që Akademia e Forcave të Armatosura ka planifikuar të hapë për vitin akademik 2023-2024 e në vijim, metodat e mësimdhënies, praktikat më të mira të trajnimit të mësuesve si dhe çështje të tjera me interes reciprok.

Programet Bachelor do të kenë një kohëzgjatje 4-vjeçare dhe në fokus të saj do të kenë krijimin e drejtuesve me integritet, të pajisur me aftësi të plota në fushën ushtarake, në fushën akademike si dhe të përgatitur fizikisht për t'i shërbyer vendit si oficerë në Forcat e Arma-



tosura të Republikës së Shqipërisë.

Bashkëpunimi me Akademinë Ushtarake Amerikane të "West Point" do të vijojë të intensifikohet në vijim me synim jo vetëm rritjen

tonë cilësore drejt standardit më të lartë të përgatitjes së oficerëve por edhe përafrimin e gjithë metodologjisë e frymës së përgatitjes sipas modelit Amerikan.

Në ambientet e auditoriumit të MM, u zhvillua ceremonia e diplomimit të kursantëve të Kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm.

Në këtë ceremoni morën pjesë komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Albert Mullai, dekani i Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, kolonel Flamur Hadushi, atasheu ushtarak i Republikës së Kosovës i akredituar në vendin tonë, nënkolonel Enver Hoti, drejtorë të Akademisë së Forcave të Armatosura, drejtues departamentesh, pedagogë dhe stafi mbështetës i AFA-së.

Komandanti i AFA-së, gjeneral brigade Albert Mullai, në fjalën e hapjes, duke falënderuar të gjithë pjesëmarrësit, theksoi rëndësinë e këtij kursi, cilësinë e përgatitjes së oficerëve në këtë kurs si një hallkë kyçe në karrierën e oficerit pasi kalon nga niveli bazik në nivelin operativ e strategjik në punën në shtabe po edhe në drejtim të komandim kontrollit. Më tej ai theksoi duke iu drejtuar oficerëve të sapo diplomuar:

Gjeneral brigade Albert Mullai: Cilësia e përgatitjes së oficerëve në këtë kurs, hallkë kyçe për karrierën e oficerit



"Kursi që sapo përfunduar përbën një ngjarje të shënuar në karrierën tuaj ushtarake, pasi ju ka pajisur juve me njohuritë e nevojshme për të punuar në nivel shtabi brigade, të aftë për të planëzuar operacione luftarake në një mjedis kompleks operacional, por mbi të gjitha ai përbën një moment të rëndësishëm në

kuptimin e forcimit të kohezionit mes drejtuesve të ardhshëm të FA-së".

Në këtë ceremoni u diplomuan 50 oficerë të Forcave të Armatosura dhe 14 oficerë nga FSK.

Në përfundim të kësaj ceremonie u zhvillua ceremonia e ndarjes së diplomave për të gjithë oficerët e sapo diplomuar.

Nënshkruhet marrëveshje bashkëpunimi mes AFA-së dhe Universitetit "Luarasi"

Akademia e Forcave të Armato-sura po vijon të shtojë vlerat e saj, si i vetmi Institucion i Arsimit të Lartë për Mbrojtjen dhe Sigurinë në vend.

AFA dhe Universiteti "Luarasi" në Tiranë nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi, e cila do të mundësojë shkëmbim personeli akademik dhe studentësh në lëndët me interes të përbashkët, bashkëpunim në fushën e kurrikulave, konferenca e praktika të përbashkëta dhe studime të thelluara në fusha si Siguria Kombëtare, Marrëdhëniet Ndërkombëtare, Siguria Kibernetike, etj.

Marrëveshja u nënshkrua nga dy rektorët profesor dr. Ethem Ruka dhe gjeneral brigade dr. Albert Mullai.



Studentët e vitit II të programit Bachelor zhvillojnë stërvitjen "Fushim veror"

Studentët e vitit II të programit Bachelor në Shkenca Ushtarake, nën drejtimin e pedagogëve të Departamentit të Formimit Ushtarak, po zhvillojnë në rajonin e Spillesë lëndën "Fushim veror".

Programi i lëndës përmban veprime praktike për ngritjen dhe funksionimin e kampingut, përgatitjen dhe organizimin e sistemit të shërbimit të ruajtjes dhe drejtimit, krijimin e kushteve për punë dhe jetesë në fushim, veprime taktike në nivel toge për kalimin e pengesave ujore, mësim noti etj.

Gjatë gjithë zhvillimit të programit mësimor, studentët kanë demonstruar përkushtim në realizimin e tij, si dhe shpirt të lartë gare dhe grupi në aktivitetet sportive.

Fushimi është vizituar edhe nga Komandanti i AFA-së, gjeneral brigade Albert Mullai, i cili ka vlerësuar angazhimin dhe përpjekjet e studentëve dhe pedagogëve për realizimin e programit.

Mbyllja e fushimit veror, i paraprin sezonit të provimeve të semestrit të dytë për studentët e ciklit Bachelor.



Në këtë fillim korriku, Komanda e Forcës Ajrore, kremtoi 91-vjetorin e krijimit të Armës së Mbrojtjes Kundërajrore (MKA) me një ceremoni të thjeshtë, me praninë e komandantit të Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj, shefit të Shtabit, kolonel Arben Cenolli, drejtues të strukturave të vartësisë të Forcës Ajrore, ish-komandantë të Mbrojtjes Kundërajrore, veteranë të kësaj arme në vite si dhe pjesëtarë të Forcës Ajrore.

Në fjalën e tij përshëndetëse, gjeneral brigade Pulaj u uroi mirëseardhjen të ftuarve, të cilët i cilësoi dëshmitarë të rrugës së vështirë nëpër të cilën ka kaluar arma e artillerisë kundërajrore, duke përshkruar disa prej momenteve më të rëndësishme historike të kësaj arme.

Në vijim, gjeneral Pulaj kujtoi me respekt komandantin e parë të Mbrojtjes Kundërajrore, gjeneral Gjin Markun si dhe komandantë të tjerë të MKA, si Sotir Filto, Arif Hasko, Todi Naço, Bejto Isufi, Kiço Janku, Naum Gjiniqasi, Pali Pritfi, Ylli Dimraj.

Në përfundim të fjalës së tij, komandanti i Forcës Ajrore adresoi një nderim për dëshmorët e kësaj arme dhe mirënjohje për familjet e tyre, si dhe përmendi kontributin aktual të Forcës Ajrore në strukturat ajrore operacionale dhe taktike të NATO-s, si dhe me asete moderne të vëzhgimit ajror dhe kompletimit me elementë të mbrojtjes ajrore të bazuara në tokë, në vitet në vazhdim.

Në emër të të ftuarve, fjalën përshëndetëse e mbajti ish-komandanti i Regjimentit të MKA-së z. Gëzim Punavia.

Në fund të ceremonisë, u shpërndanë certifikata mirënjohje për ish-ushtarakët e shquar të Armës së Mbrojtjes Kundërajrore në vite.

Forca Ajrore: 91 vite, krijimi i Armës së Mbrojtjes Kundërajrore



Helikopteri i Forcës Ajrore EC kryen tre operacione shpëtimi brenda ditës

Helikopteri i Forcës Ajrore EC-135 së bashku me ekuipazhin pilotë e teknikë të përkushtuar, ka kryer brenda ditës tre operacione shpëtimi, në zona të thella të vendit, në një terren të vështirë.

Në misionin e parë, i është ardhur në ndihmë një punonjësi të ujësjellësit të bashkisë Himarë, i cili ishte dëmtuar në Malin i Çikës, dhe më pas u transportua në Spitalin Universitar të Traumës në Tiranë.

Misioni i dytë u krye gjithashtu në Himarë duke i ardhur në ndihmë një gruaje me probleme kardiake, e cila u evakuua drejt spitalit nën asistencën e ekipit mjekësor.

Helikopteri EC, misionin e tretë e kreu nga Qafa e Pejës drejt spitalit rajonal të Shkodrës, duke transportuar një turistë gjermane, e cila kishte pësuar frakturë gjatë eksplorimit të zonës.



Helikopterët e Forcës Ajrore kryen ambulanca ajrore në Vlorë dhe në Tropojë

Ekuipazhi i helikopterit së transportit të shëndetësisë EC dhe ekuipazhi i njësisë së RENE-s kryen operacione fluturuese në një kohë të shpejtë, në një terren të vështirë.

Misioni i parë kreu një operacion fluturues, përkatësisht: ambulancë ajrore në Vlorë, duke transportuar dy pacientë nga Palasa drejt Spitalit të Traumës, në Tiranë.

Misioni i dytë kreu një operacion fluturues në Valbonë, Tropojë, duke transportuar personel mjekësor dhe efektivë të Policisë së Shtetit drejt vendit "Maja e Grykave".

Misioni i tretë kreu një operacion fluturues, përkatësisht: ambulancë ajrore në Valbonë, Tropojë, duke transportuar të sëmurë nga vendi i quajtur "Maja e Grykave", drejt spitalit të qytetit të Shkodrës.



Gjeneral brigade Pulaj: Forca Ajrore shqiptare do të ofrojë gjithë kapacitetet e saj për zhvillimin e FSK-së edhe në domenin ajror

Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Forcës Ajrore të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, një ekip i FSK, kryesisht pilotë, zhvilluan një vizitë disaditore në njësitë dhe repartet e Forcës Ajrore si edhe në strukturat e "Albcontrol sh.a.".

Ky ekip i FSK-së u prit në takim të veçantë edhe nga komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Pulaj, i cili në fjalën e tij theksoi se ndërmjet Forcës Ajrore të Republikës së Shqipërisë dhe pilotëve të FSK-së, do të këtë bashkëpunimin të vazhdueshëm, jo vetëm për të parë nga afër procesin e punës të koordinimeve të fluturimeve mes kullës ajrore civile dhe asaj ushtarake, mënyrën e organizimit të strukturave të Komandimit Kontrollit Ajror dhe procedurat e koordinimit me strukturat homologe civile, por se Forca Ajrore shqiptare do të ofrojë të gjithë ekspertizën dhe kapacitetet e saj për zhvillimin e FSK edhe në domenin ajror.



Ekipi i FSK-së zhvilloi vizita dhe takime të veçanta në komandën e Forcës Ajrore, Bazën Ajrore Farkë, si dhe në Agjencinë Kombëtare Të Menaxhimit Të Fluturimeve në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë, "Albcontrol sh.a." në Rinas.

Ky aktivitet u pasqyrua dhe në NATO, mediat e KFOR-it si dhe min-

istri i Mbrojtjes i Kosovës, Armend Mehaj, shprehu në postimin e tij se: "Forcat Ajrore të Republikës së Shqipërisë mbështesin Repartin Ajror të FSK-së. Ne vazhdojmë së bashku të rrisim kapacitetet tona të përbashkëta në aftësitë e mbrojtjes ajrore. Së bashku jemi gjithmonë më të fortë".

Helikopteri "Cougar" shuan vatrat e zjarreve që rrezikonin zonën e mbrojtur të pyjeve Berzanë, Lezhë

Helikopteri "Cougar" me ekuipazhet e pilotëve dhe teknikëve në bord kryen misionin e ndërhyrjes nga ajri për shuarjen e zjarrit në njësinë administrative Zejmen në Lezhë.

Operacionet nga ajri, gjatë ditës janë kryer mbi sipërfaqe pyjore pranë zonës së mbrojtur në Bërzanë, duke bërë të mundur eliminimin e vatrës së zjarrit në pyjet e këtij rajoni nëpërmjet hedhjes së ujit me kovën e posaçme "Bambi Bucket".



Helikopteri i Forcës Ajrore kreu dy operacione fluturuese, në shpëtim të jetëve njerëzore

Helikopteri i njësisë së transportit të shëndetësisë së Bazës Ajrore Farkë kreu dy operacione fluturuese, përkatësisht: ambulanca ajrore në Peshkopi, duke transportuar një të sëmurë dhe në Valbonë duke bërë të mundur evakuimin e alpinistëve të lënduar në 2 328 metra lartësi në majën e Zhaporrës.

Ekuipazhi i helikopterit EC kreu dy operacionet fluturuese në një kohë të shpejtë, në një terren të vështirë, gjithsej 2 orë e 50 minuta fluturim.

Transportimi përkatësisht i të sëmurit nga Peshkopia dhe alpinistëve të lënduar nga Valbona, të cilët ishin bllokuar në një zonë të thepisur, u dërguan për ndihmë të specializuar në Spitalin Universitar të Traumës në Tiranë.





Gjeneral brigade Arben Kingji, vizitë zyrtare në Fort Drum, NY, SHBA

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Arben Kingji, zhvilloi një vizitë zyrtare në Fort Drum, NY, SHBA. Gjatë kësaj vizite, së bashku me Adjutant Komandanten e Gardës Kombëtare të New Jersey-it, gjeneral brigade Lisa Hou, vizituan ushtarakët e Brigadës së 44-të të Këmbësorisë, në kuadër të stërvitjes "eXportable Combat Training Capability", ku pjesë e këtij trajnimi janë edhe 47 efektive nga Grup Batalioni i Këmbësorisë së Lehtë.



Batalioni i Parë i Këmbësorisë, pjesë e operacionit për fikjen e zjarrit dhe mbajtjen nën kontroll të tij, në zonën e Oroshit, Mirditë.



Komandanti i Forcës Tokësore merr pjesë në Konferencën e Forcave Tokësore Europiane

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Arben Kingji mori pjesë në Konferencën e Forcave Tokësore të 37 vendeve të Europës, ushtrisë amerikane dhe Kanadasë. Ky aktivitet, i cili u zhvillua në Gjermani, u organizua dhe drejtua nga Komanda e Ushtrisë Amerikane për Europën dhe Afrikën, me pjesëmarrjen e drejtuesve më të lartë të kësaj komande.

Përgjatë tre ditëve të zhvillimit të saj, konferenca u thellua në diskutime mbi një larmi temash siç ishin sfidat aktuale dhe çështjet e sigurisë e gatishmërisë, ndërveprueshmërisë mes aleatëve dhe partnerëve, si dhe projektet e ardhshme të modernizimit të mëtejshëm, për mbrojtjen dhe sigurinë



e përbashkët. Konferenca e Forcave Tokësore europiane, shërbeu për rritjen dhe thellimin

e mëtejshëm të bashkëpunimit reciprok, në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Arben Kingji, inspekton zhvillimin e stërvitjes së përbashkët mes forcave speciale shqiptare dhe forcave speciale amerikane, "JCET-22"



Ekipi i snajperëve të Grup Batalionit të Këmbësonisë së Lehtë, zhvillon trajnimin e qitjeve me snajper në Fort Drum, SHBA, për mbrojtjen e rajoneve të përkohshme të përqendrimit, nga elementë të rrezikshëm "hostile".



Ekspertët amerikanë trajnojnë personelin e Grup Batalionit të Këmbësonisë së Lehtë, mbi përdorimin dhe montimin në mjete të radiove "Type One"



Grup-Batalioni i Këmbësonisë së Lehtë përfundon me sukses trajnimin në Fort Drum, SHBA, si pjesë e stërvitjes "eXportable Combat Training Capability", me batalionin 2-113 të Brigadës së 44-t të Gardës Kombëtare të New Jersey-it.



U zhvilluan në Athinë bisedimet e Shtabit (Staff Talks) me Forcën Detare të Greqisë. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte diskutimi rreth fushave të bashkëpunimit dypalësh midis dy Forcave Detare për vitet 2023 - 2024.

Në këtë aktivitet morën pjesë shefi i Shtabit të Forcës Detare, kapiten i Rangut I Sabri Gjinollari, shefi i Degës së Planifikimit/Programimit kapiten i Rangut II Erjet Huqi dhe shefi i Zyrës së Komandantit, kapiten i Rangut III Blendi Melishte.

Gjatë zhvillimit të bisedimeve të Shtabit me Forcën Detare të Greqisë u diskutuan dhe dakordësuan zhvillimi i stërvitjeve të përbashkëta detare dhe planëzimi operacional, pjesëmarrja e përvitshme në stërvitjen e organizuar nga Forcat Detare të Greqisë 'NIIIRIS', vizita të ndërsjella portuale, trajnimi i personelit të Forcës Detare të Shqipërisë në qendrat e trajnimit të FD të Greqisë, bashkëpunimi në iniciativat shumëpalëshe, bashkëpunimi në projektet e modernizimit, imbarkimi i oficerëve të FD të Shqipërisë në anijet e Forcës Detare të Greqisë gjatë dislokimit në operacionin e NATO-s FOCOPS etj.

Shefi i Shtabit të Forcës Detare merr pjesë në zhvillimin e bisedimeve të Shtabit me Forcën Detare të Greqisë



Në nder të vizitës së delegacionit të Forcës Detare në Greqi, zëvendëskomandanti i Forcës Detare greke mirëpriti kapiten i Rangut I Sabri Gjinollari në një takim kortezie.

Në përfundim të bisedimeve të Shtabit, u shpreh interesi i përbashkët për rritjen e bashkëpunimit nëpërmjet identifikimit të fushave të reja dhe të përmirësohet më tej bashkëpunimi dypalësh.

Prej konstatimit të bërë nga helikopteri i misionit "Frontex" se një mjet lundrues "gomone" në veriperëndim të ishullit grek Othonoi po lëvizte me shpejtësi të 40 nje. Roja Bregdetare (RB), Policia e Migracionit dhe Kufirit (PKM) si dhe Delta Forcës (DF), të cilat ishin në gatishmëri në Porto-Palermo, Himarë, Sazan dhe Vlorë u vunë në ndjekje.

Për më shumë se 14 orë dhe 200 milje detare të përshkuara ka zgjatur operacioni në ndjekje të mjeti lundrues i dyshuar se transportonte lëndë narkotike.

Operacioni për ndjekjen dhe bllokimin e gomones është kryer në bashkëpunim me Policinë Kufitare dhe të Migracionit, misionin e Bashkimit European "Frontex", Delta Forcës dhe Guardia di Finanza-s. Ndjekja e mjetit të dyshuar është bërë përgjatë gjithë bregdetit shqiptar duke angazhuar në operacion anije nga vendbanimi i ishullit të Sazanit, Durrësit dhe Shëngjinit. Forca Detare ka marrë pjesë në këtë operacion me tre anije duke bërë ndjekjen e objektit nga momenti i diktimit në rajonin

Forca Detare, pjesë e operacionit në ndjekjen e gomones që dyshohej për transportimin e lëndëve narkotike



e jugut deri në kufirin me Malin e Zi. Ndjekja e objektit është kryer në kohë reale edhe nëpërmjet Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare (SIVHD).

Anija P-134 "Lissus" ka shërbyer si një koordinuese midis mjeteve ajrore të "Frontex" (një helikopter dhe një avion) dhe forcave të tjera pjesëmarrëse si dhe me anë të kamerave termike ka bërë diktimin e objektit disa herë gjatë ndjekjes. Operacioni

është koordinuar edhe me Qendrën Operacionale të Malit të Zi, me të cilën janë shkëmbyer informacione në kohë reale për vendndodhjen, drejtimin dhe shpejtësinë e objektit të dyshuar. Pas përpjekjeve të dështuara për t'iu shpëtuar forcave të zbatimit të ligjit, mendohet se mjeti i dyshuar është mjeti i cili është gjetur nga forcat e PKM i braktisur dhe në zonën e Patokut, në gjirin e Drinit.

Trupat zjarrfikëse të BMEC, në gatishmëri për t'iu përgjigjur thirrjes në përballimin e emergjencave civile

Prej disa ditësh, 40 efektivë, 2 mjete zjarrfikëse dhe 1 autoambulancë janë aktivizuar nga BMEC për të kryer operacionet e fikjes së vatrave të zjarrit. Që në ditën e parë të aktivizimit të zjarreve u desh të veprohej në dy zona njëkohësisht, në Krastë të bashkisë Krujë dhe Orosh të bashkisë Mirditë.

Era e fortë dhe terreni malor e bënin të vështirë kryerjen e detyrës nga efektivat BMEC. Në këto terrene u punua dhe natën për të bërë të mundur krijimin e brezave për parandalimin e përhapjes së zjarrit dhe eliminimin e vatrave të krijuara.

Sfidë për efektivat e BMEC në fikjen e zjarrit ka qenë zona e Balldrenit, ku zjarri arriti në afërsi të zonave të banuara. U desh

ndërhyrja e zjarrfikëses, që bëri ndalimin e vërshimit të zjarrit në shtëpitë rrëzë malit. Erës së fortë dhe terrenit të thepisur iu shtuan dhe plasjet e municioneve luftarake, që aktivizoheshin nga zjarri. Me përkushtim dhe masa të shtuara sigurie u bë i mundur eliminimi i shumë vatrave të zjarrit dhe kthimin e situatës në normalitet.



FA dhe Emergjencat Civile në mbrojtje të komunitetit dhe pasurisë natyrore

67 efektivë dhe 7 mjete nga Baza e Mbështetjes së Emergjencave Civile dhe Forcës Tokësore u angazhuan për shuarjen e vatrës së zjarrit në malin Tole, në zonën e Krastës, në Krujë. Kjo vatër e fikur një ditë më parë, pati aktivizime të vatrave të reja. Në zonë ndodheshin edhe forca të Agjencisë së Mbrojtjes Civile, zjarrfikësit nga Durrësi dhe Kruja si dhe punonjës të administratës vendore dhe vullnetarë.

Pas njoftimit të marrë për gjetjen e një municioni të paplasur, i cili rrezikonte jetën e banorëve të fshatit Ziçisht, pesë efektivë EOD u gjendën menjëherë në vendndodhjen e raportuar, ku nën masa të larta sigurie dhe pas një pune të kujdesshme, u konstatua se municioni ishte një predhë artilerie 76 mm me djegore të vendosur. Nisur nga kjo gjendje, ky municion u cilësua si i paprekshëm dhe i palëvizshëm. Specialistët morën vendimin që kjo predhë ishte e rrezikshme të transportohej dhe u realizua asgjësimi i saj në vend.

Pas kësaj ekipi EOD e vazhdoi detyrën në fshatin Koshnicë ku, pas rikonicionit të municionit, rezultoi se ai ishte një granatë dore mësymëse me tapë e pa ndezës. Ky municion u mor për t'u magazinuar në repart.

Specialistët EOD eliminojnë rrezikun e municioneve të paplasura në fshatrat Ziçisht dhe Koshnicë, Bashkia Korçë





INTERVISTË ME DREJTORIN E IKSHU-së, ULSI REXHAJ



Intervistoi:
Shefe e Sektorit të Botimeve
Anjeza Musollari

Qendra e Simulimit, inovacion, planifikim, projektim, përgatitje për komandantët, shtabet dhe liderët e së ardhmes

Qendra e Simulimit, si një risi e FA-ve, mjaft e rëndësishme për kontributin e saj operacional e projektuar, kompletuar dhe pajisur për të siguruar një mjedis trajnues me standardet e duhura të një ushtrie që aderohet në forcën më të madhe transatlantike, vjen për publikun e gjerë nëpërmjet drejtorit të IKSHU kolonel Ulsi Rexhaj, i cili sjell në vëmendje aktivitetin dhe rëndësinë e kësaj qendre.

Kur ka filluar funksionimin e saj Qendra e Simulimit dhe cilat kanë qenë stërvitjet e para të realizuar në Qendër?

Qendra e Simulimit (QS) ka nisur funksionimin në datën 24 tetor 2012, me mbështetjen e Zyrës Amerikane të Bashkëpunimit për Mbrojtjen. Iniciativa për krijimin e një kapaciteti mbështetës për stërvitjet në FARSH, nëpërmjet sistemeve të simulimit, ka nisur realisht që në vitin 2007 e përpjekjet kanë vijuar ndër vite për prokurimin e pajisjeve, strukturimin e plotësimin me personel dhe arritjen e funksionimit normal të saj. Në vitet 2012-2017 në QS ka qenë i pranishëm një ekip i kontraktuar i kompanisë amerikane CUBIC, i cili ka ofruar asistencë teknike për personelin e qendrës sipas konceptit "over the shoulder".

Stërvitjet e para të realizuara nga qendra kanë pasur karakter eksperimentues dhe konsolidues për procedurat dhe teknikat në përdorim dhe janë realizuar me kurset institucionale të institucioneve arsimore të FARSH, si cikli i stërvitjeve "Preza 2012-2013", e realizuar me kursantët e KTHOSH në AFA, ndërsa stërvitjet e para të mirëfillta të mbështetura nga QS kanë qenë "Joint Reaction 13", një stërvitje në nivel "Joint", nën kornizën e iniciativës së Kartës së Adriatikut, me pjesëmarrjen e forcave të SHBA-ve dhe vendeve të A-5 me qëllim rritjen e bashkëpunimit, koordinimit dhe ndërveprimit në operacione ushtarake në përgjigje të krizave, si dhe stërvitja kombëtare "SFJZ 13 South", "Manza 13", "Shkumbini 13", etj.

Çfarë përfaqëson kjo qendër dhe cili është ndikimi i saj në procesin e stërvitjes dhe trajnimit në FARSH?

Qendra është një institucion inovator për rritjen e efikasitetit dhe përmirësimin e kapaciteteve stërvitore kolektive në FARSH. Synimi kryesor i Qendrës, që nga themelimi i saj ka qenë të shërbejë si një katalizator për rritjen e kapaciteteve operacionale dhe përgatitjes profesionale të efektivëve të FARSH-it, nëpërmjet përdorimit të burimeve efikase njerëzore dhe teknike në disponim, si dhe futjes dhe implementimit të metodave të reja e bashkëkohore stërvitore, në përputhje me standardet e NATO-s dhe vendeve të zhvilluara.

Në procesin e stërvitjes dhe trajnimit në FARSH, Qendra e Simulimit ruan një rol të rëndësishëm, i cili mund të vërehet edhe në numrin e stërvitjeve të mbështetura nga Qendra, por dhe përfshirjen e saj në aktivitetet kryesore stërvitore e të planëzimit stërvitor në nivel FARSH. Që nga viti 2012, QS ka mbështetur rreth 90 për qind të stërvitjeve kolektive, ndër të cilat 26 stërvitje kombëtare në nivel togë/kompani, 35 stërvitje në nivel batalioni, 4 stërvitje në nivel brigade, dhe 10 stërvitje me karakter ndërinstitutional. Gjithashtu QS ka mbështetur 12 stërvitje të përbashkëta të realizuara me partnerë ndërkombëtarë, dhe 5 stërvitje të realizuara në kuadër të NATO-s. Numri total i personelit vendas e të huaj të angazhuar në stërvitje të mbështetura nga QS ndër vite është rreth 8000 vetë.

Ndërkohë QS është pjesëmarrëse e pazëvendësueshme në të gjitha aktivitetet planëzuese stërvitore në nivel kombëtar, e gjithnjë e më shumë efektiv i QS angazhohet në struktura planëzuese të nivelit më të lartë edhe në stërvitje të përbashkëta në të cilat angazhohet FARSH. Këto rezultate janë krenaria e QS, dhe gjithashtu përbëjnë një motivim të shtuar për

personelin e QS.

Cili është misioni dhe detyrat kryesore të Qendrës?

Misioni i Qendrës është "trajnimi dhe zhvillimi i stërvitjeve me simulim i personelit ushtarak të FARSH, ndërinstitutionale, kombëtare dhe ndërkombëtare, në përputhje me bazën kombëtare doktrinare e konceptuale dhe atë të NATO-s, si dhe testimi i procedurave të vendimmarrjes, të komandave dhe shtabeve nëpërmjet metodave aplikative bashkëkohore", ndërsa detyrat kryesore të saj janë:

- Drejtimi dhe menaxhimi i stërvitjeve me simulim.
- Aplikimi i metodave dhe teknologjisë së përpunuar për trajnim e stërvitje, përfshirë programet JCATS, VBS dhe JEMM, si dhe gjenerimi dhe krijimi i një mjedisi efektiv dhe real dhe me një kosto të ulët.
- Hulumtimi mbi performancën në stërvitje dhe propozime për përmirësimin e gjendjes.

Çfarë përfitimesh sjell përdorimi i simulimit në stërvitje dhe si i shërbejnë ato FARSH?

Simulimi është një metodë që përdoret gjerësisht si në fushën ushtarake, ashtu edhe në fusha të ndryshme të industrisë dhe botën akademike, si një mjet

Viti	Stërvitje kombëtare				Stërvitje ndërkombëtare		Total	Pjesëmarrës (ASK+ASD)
	Togë/komp.	Batalion	Brigadë	Ndërinstit.	Rajonale	NATO		
2013	3	4			1		8	807
2014	4	5		2			11	1026
2015	4	5			3		12	953
2016	3	2	1	1		1	8	1958
2017	4	4	1	1		1	11	1000
2018	4	3	2	1	2		12	850
2019	3	4		2	4		13	1180
2020	(2)	(3)	(1)	(1)	1 / (1)		1 (8)	80
2021	(2)	3		(1)	(1)	1	4 (4)	350
2022	1	5		3	1	2	12	
TOTAL	26(4)	35(3)	4(1)	10(2)	12(2)	5	92(12)	7854
	65(8)			10(2)	17(2)			

që mundëson aktivitete trajnimi/stërvitjeje, edukimi dhe ato kërkimore e shkencore, me kosto të reduktuar dhe rreziqe operacionale të papërfillshme. Në rastin tonë, programet simulative mundësojnë mbështetjen dhe realizimin e stërvitjeve kolektive të forta dhe në kushte sa më reale, duke arritur përmbushjen e objektivave stërvitore të shtabeve e planëzuesve në nivele të ndryshme, me një kosto pothuajse të papërfillshme në krahasim me kostot e zhvillimit të të njëjtave stërvitje në terren. Por, krahas kostos së reduktuar dhe realizimit të stërvitjeve dhe trajnimeve në një mjedis të kontrolluar, simulimi dhe përdorimi efektiv i programeve simulative për stërvitje e trajnim i ndihmon liderët e të gjitha niveleve të arrijnë ekspertizën taktike dhe teknike që nevojitet për operacionet të suksesshme luftarake dhe jo luftarake, brenda vendit dhe në kuadrin e Aleancës, duke "provuar veten" në skenarë të ndryshëm.

Si realizohen stërvitjet me simulim? Si realizohen stërvitjet e ndërthurura livex/simex dhe si angazhohet QS në to?

Stërvitjet me simulim ndjekin të njëjtat parime e

metodologji planëzimi sikurse dhe stërvitjet tradicionale në terren. Publikimi i NATO-s "075-003" i vitit 2013, "Direktiva për stërvitjet dhe trajnimet kolektive", e njohur nga ekspertët e fushës si "BISC 075-003", jep një panoramë të plotë të të gjitha aktiviteteve planëzuese për çdo etapë stërvitore. Gjithashtu kjo direktivë, e cila është një dokument thelbësor në përdorim nga QS, parashtrohet dhe kërkesat e veçanta në kuadër të ndërthurjes së simulimit dhe eksperimentimit në stërvitjet e trajnime kolektive. Përfitimet që sjell simulimi në aspektin teknik të menaxhimit të stërvitjeve e trajnimeve, lejojnë formësimin e skenarëve të ndryshëm dhe elementëve të ndryshëm kundërshtarë e jo vetëm pjesëmarrës në to, duke i ofruar njësive e forcave nën trajnim kushte optimale për realizimin e objektivave stërvitore të vendosura. Por gjithashtu, duhet mbajtur parasysh se përdorimi optimal i programeve simulative kërkon ekspertizë dhe kapacitete teknike të caktuara, dhe sidomos se simulimi është plotësues i metodave tradicionale të stërvitjes/trajnitimit dhe jo zëvendësues.

Në konceptin aktual të stërvitjeve dhe trajnimeve kolektive, simulimi paraqet një mjet të fuqishëm për realizimin e objektivave të stërvitjeve e trajnimeve, dhe në praktikë gjithnjë e më shumë vendet e Aleancës e përdorin simulimin për stërvitjen e trajnimin e shtabeve dhe udhëheqësve ushtarakë të niveleve të ndryshme, krahas stërvitjes në kushte reale. Stërvitja në një mjedis të ndërthurur, simulativ dhe real, është sfida e stërvitjes dhe trajnitimit ushtarak të së ardhmes. Sipas karakteristikave të këtyre stërvitjeve dhe sidomos objektivëve stërvitorë të vendosur, një pjesë e njësive në stërvitje kryejnë veprimtarinë në terren real, ndërsa një pjesë tjetër e veprimtarive stërvitore kryhet në mjedis të simuluar. Këtu duhet mbajtur parasysh se stërvitje të këtilla janë zakonisht të llojit komandë-shtabi, dhe sipas kërkesave specifike të stërvitjes, shtabet e niveleve të ndryshme mund të angazhohen në mjedise të veçanta. Këto lloj stërvitjesh paraqesin një sfidë të veçantë jo vetëm për planëzuesit e stërvitjeve në njësitë nën trajnim, por sidomos dhe stafin teknik mbështetës, sidomos ata të simulimit.

QS në vitet e fundit ka pasur mundësinë të angazhohet e të ofrojë mbështetje në dy stërvitje të përbashkëta madhore të realizuara në një mjedis stërvitor të ndërthurur, stërvitjet "Joint Effort 16" dhe "Defender Europe 21", si dhe disa stërvitje komëtare.

Cilat janë karakteristikat e sistemit stërvitor në QS?

Sistemi stërvitor në QS është një kombinim i tre elementeve kryesore e të pazëvendësueshme: personeli i specializuar, programet e simulimit në disponim dhe infrastruktura mbështetëse, ku përfshihen mjetet e pajisjet e teknologjisë së informacionit, si dhe infrastruktura didaktike e përshtatshme. Të gjithë këto elementë funksionojnë së bashku e njëkohësisht për të mbështetur stërvitjen në përputhje me doktrinat, teknikat dhe procedura të miratuara. Ndërveprimi e



funksionimi sinergjik i të gjithë këtyre elementëve është i domosdoshëm për realizimin e misionit të qendrës, prandaj dhe një pjesë e veçantë e vëmendjes së QS i kushtohet aftësimit e trajnimit të vazhdueshëm të stafit dhe testimit e kolaudimit të infrastrukturës digjitale e fizike.

Çfarë metodologjish dhe programesh simulative përdoren aktualisht në QS?

Qendra e Simulimit ka në përdorim dy programe simulimi. Këto përfshijnë:

1. Programin për Simulimet Taktik dhe të Konfliktit të Përbashkët (JCATS)
2. Programin Hapësira Virtuale e Betejës 2 (VBS-2)

Të dy programet janë sisteme të mirënjohura dhe të përdorura gjerësisht nga vendet e NATO-s, dhe shumë vende të tjera.

Programi i simulimit JCATS është sistem simulimi i përbashkët, gjithëpërfshirës (forcë ajrore, tokësore, dhe detare) dhe ndërveprues me rezolucion të lartë dhe me përshtatshmëri në të gjithë spektrin e kërkesave operacionale. Ai mundëson modelimin e luftimeve në terren të dixhitalizuar, duke përdorur mbi 100 000 agregate dhe sisteme individuale. JCATS është shumë efektiv kur përdoret për të trajnuar komandantë dhe shtabe nga nivel kompanie deri në nivel brigade, dhe përdoret në mënyrë intensive nga SHBA-ja dhe vendet të tjera të Aleancës për të përgatitur repartet/njësitë e saj. JCATS përdoret në zgjidhjen e detyrave për të gjitha llojet e operacioneve në të cilat mund të angazhohet FARSH.

Programi i simulimit VBS2 është një platformë ndërvepruese, e bazuar në ushtrime tredimensionale, e cila përfshin një mjedis virtual me besnikëri shumë të lartë ndaj realitetit, skenarëve e drejtuesve. VBS2 mbështet simulimin e mjeteve tokësore detare e ajrore, armët e kalibrit të vogël dhe armët në mjete, komunikimin, radarët, dylbitë termalë dhe forca kundërshtarë ndëraktive, duke përfshirë një shumëllojshmëri të mjeteve shpërthyes (IED). Për më tepër, siguron një mjedis gjithëpërfshirës në nivel personal dhe kryen trajnimin e personelit nga individë deri në

nivel toge. Karakteret mund të jenë të kontrolluar nga kompjuteri ose nga inteligjencë artificiale.

Të dyja programet e simulimit janë të instaluar, operacionale dhe të përdorura vazhdimisht nga QS në stërvitjet e planëzuara të FARSH. Ndërkohë QS është gjithnjë e përditësuar me zhvillime të reja teknologjike dhe metodologji të ndryshme në përdorim kryesisht nga Aleanca. Si institucion me ekspertizë në këtë fushë ndjek zhvillimet në sektorin e simulimit për përdorim ushtarak, si dhe ofron propozime, duke u mbështetur në disa parime kryesore, të cilat janë:

- Raporti kosto-përfitim në investimin për përtithjen e sistemeve simulative - Sistemet stërvitore me simulim janë relativisht sisteme të kushtueshme për ushtri me kapacitete të kufizuara, dhe krahas kostonë së prokurimit të programeve të veçanta simulative, duhet përllogaritur kostoja e gjithë elementëve të sistemeve stërvitore me simulim (personel dhe infrastrukturë, krahas programeve).

- Përputhja e kapaciteteve simulative me nivelin e ambicies kombëtare/ nevojën për stërvitje/trajtime kolektive dhe individuale - Sistemet simulative duhet të përzgjidhen në përputhje me synimet e ambicies kombëtare për kapacitetet ushtarake. Gjithashtu, duhet mbajtur parasysh se simulimi është plotësues i metodave tradicionale të stërvitjes/trajnit dhe jo zëvendësues i tyre.

- Përzgjedhja e programeve simulative për përdorim të sintetizuar të tyre në stërvitje - Sistemet e simulimit për stërvitje/trajnim duhet të përzgjidhen në mënyrë të atillë që të garantojnë bashkëveprim midis tyre dhe një mjedis stërvitor sintetik.

- Ndërveprueshmëria e sistemeve simulative në nivel Combined&Joint (NATO) - Investimet në sisteme simulative duhet të synojnë arritjen e ndërveprueshmërisë së plotë me sistemet simulative në përdorim të aleatëve/partnerëve kryesorë. Gjithashtu investimet e përbashkëta mund të rezultojnë shpesh herë më të favorshme se investimet kombëtare individuale.

- Nevoja për stërvitje e testim/kolaudim të operacionalitetit të sistemeve C4ISR dhe sistemeve të armatimit në disponim nga FA - Sistemet simulative janë të lidhura kryesisht me nevojën për stërvitje/trajnim me sistemet C4ISR dhe ato të armatimit në disponim. Nëse nuk ka sisteme C4ISR apo armatimi komplekse nevoja për sisteme simulative komplekse reduktohet.

A ka kjo qendër burime njerëzore dhe logjistike për mbështetjen me efikasitet të stërvitjeve, dhe cilat janë sfidat në këtë aspekt?


Si pjesë e pazëvendësueshme e sistemit stërvitor në qendër, elementët e personelit dhe infrastrukturës, kanë një rëndësi thelbësore për mirëfunksionimin e QS.

Me kapacitetet e saj, QS është e angazhuar për trajnimin e vazhdueshëm të personelit dhe mirëmbajtjen e infrastrukturën në përdorim. Trajnimi i personelit ka qenë një ndër drejtimet kryesore të punës në QS dhe sidomos përcjellja e njohurive gjatë lëvizjeve të personelit. Investimet e vazhdueshme me qëllim kufizimin e ndikimit të amortizimit në pajisje e infrastrukturë mbesin një sfidë për QS.

Me qëllim forcimin e kapaciteteve ekzistuese dhe rritjen e kapaciteteve stërvitore QS është përfshirë së fundmi në një projekt investimi e modernizimi i cili pritet t'i japë një frymëmarrje të re Qendrës, por edhe të zgjerojë aftësitë trajnuese e stërvitore të saj.

Çfarë siguron aktualisht Qendra e Simulimit? Cilat janë sfidat dhe cilat janë synimet e saj?

QS ofron për gjithë njësitë e FARSH dhe institucioneve të mbrojtjes e sigurisë në vend një kapacitet stërvitor e trajnues, që mbështet me programe simu-



luese zhvillimin e stërvitjeve e trajnimeve kolektive, të mbështetur në praktika të standardizuara, me koston më të ulët, dhe në kohën më të shkurtër të mundshme. Gjithashtu QS ofron ekspertizë dhe mbështetje për planëzimin e stërvitjeve kolektive, një infrastrukturë të përshtatshme për stërvitje optimale për njësi në nivel batalioni, si dhe mbështetjen me materiale stërvitore (radio, harta, shënjes, materiale kancelarie, etj.) për njësitë në stërvitje, etj.

Krahas ofertës, QS është këmbëngulëse në kërkesën për të pasur një audiencë stërvitore të përgjegjshme për misionin përkatës individual dhe të motivuar për të mësuar, përmirësuar dhe aftësuar veten nëpërmjet stërvitjeve me simulim.

Në zbatim të misionit të saj, QS është e angazhuar që të ndikojë fuqishëm që në të gjithë sistemin arsimor e stërvitor të FARSH të përdoren strategji e metodologji stërvitore që nxisin aftësitë e të menduarit kritik dhe të menduarit rreth zgjidhjes konkrete të problemeve në mënyrë që të përmbushen kërkesat për përshtatje dhe sukses në mjedisin e ndërlikuar operacional të sotëm.

Pothuajse 1 në 2 gra në BE

kanë përjetuar dhunë psikologjike

Raporti i fundit i EIGE mbi kontrollin shtrëngues dhe dhunën psikologjike në të gjithë Shtetet Anëtare të BE-së provon një përhapje të lartë. Megjithatë, kanë filluar të vendosen masat e shtuara kundër kriminalizimit. Megjithatë ka ende shumë për t'u bërë.

Çfarë është kontrolli shtrëngues dhe dhuna psikologjike? Shpjegimet e mëposhtme karakterizojnë natyrën e të dyja formave të abuzimit.

- Kontrolli shtrëngues përku-fizohet si "një kurs strategjik i sjelljes shtypëse që karakterizohet zakonisht nga abuzimi fizik dhe detyrimi seksual i shpeshtë, por i nivelit të ulët, në kombinim me taktikat për të frikësuar, degraduar,

izoluar dhe kontrolluar viktimat" (Stark, 2013).

- Konventa e Këshillit të Europës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit, neni 33) e përkufizon dhunën psikologjike si "çdo sjellje e qëllimshme që dëmton seriozisht integritetin psikologjik të një personi tjetër nëpërmjet shtrëngimit ose kërcënimit".

Siç qëndron, statistikat janë grumbulluar në një realitet të zymtë. Të dhënat nga Agjencia e BE-së për

të Drejtat Themelore (FRA) treguan se në të gjithë BE-në, 44% e grave kanë përjetuar dhunë psikologjike nga një partner gjatë jetës së tyre.

EIGE rekomandon që në mënyrë specifike, eksplicite dhe gjithëpërfshirëse të trajtohet dhuna psikologjike si një fenomen i pavarur. Ai gjithashtu kërkon të përfshijë një dimension dixhital në kuadrin e parandalimit dhe reagimit që synon viktimat e abuzimit në internet, si dhe të sigurojë që praktikatat të arrijnë grupet më të rrezikuara dhe ata



që kanë nevoja shtesë.

Në hulumtimin e EIGE, gratë më të reja (nën 30 vjeç), gratë me aftësi të kufizuara ose gjendje të vështirë shëndetësore, gratë jo heteroseksuale dhe gratë me pre-jardhje emigrante përjetojnë dhunë psikologjike në një shkallë më të lartë se popullata e përgjithshme.

Implikimet e dhunës psikologjike dhe kontrollit shtrëngues janë thellësisht të thella tek gratë viktimë, ku rreziku i vetëvrasjes, depresionit dhe çrregullimit të stresit post-traumatik (PTSD) janë veçanërisht të përhapura.

Për më tepër, ndikimi negativ tek fëmijët e viktimave mund të jetë i thellë dhe mund të çojë në një rrezik të shtuar të viktimizimit dhe kryerjes më vonë në moshën madhore.

Tani, në epokën e dominimit dixhital, disa shtete anëtare po marrin parasysh ndikimin psikologjik të dhunës kibernetike. Në Itali, përdorimi i komunikimit elektronik është një rrethanë rënduese për ndjekjen dhe, në Francë, një rrethanë rënduese për ngacmimet seksuale. Në Austri, përndjekja kibernetike përmendet veçanërisht si një formë e ndjekjes në kodin penal.

Luftimi i kontrollit shtrëngues dhe dhunës psikologjike vjen me një mori sfidash, duke pasur parasysh barrierat për parandalimin efektiv. Për 28% të praktikuesve të anketuar nga EIGE për këtë projekt, mungesa e njohurive mbi dhunën psikologjike mbetet pengesa më e rëndësishme për parandalimin. Si rezultat, viktimat e kontrollit shtrëngues dhe dhunës psikologjike hezitojnë të raportojnë përvojat e tyre.

Nga këndvështrimi ligjor, në shumicën e shteteve anëtare të BE-së dhuna psikologjike ndiqet penalisht për vepra penale që nuk janë specifike për kontekstin e familjes ose të partnerit intim. Danimarka, Spanja, Franca, Hungaria dhe Irlanda kanë zbatuar vepra penale specifike për dhunë psikologjike ose kontroll me forcë. Dhe vetëm Danimarka dhe Irlanda përdorin gjuhën e kontrollit shtrëngues në legjislacion.



Sindikata Shëndetësore: HERA ofron listën e 3 kërcënimeve më të mëdha shëndetësore kundër të cilave duhet të përgatitemi

Autoriteti i Komisionit për Gatishmërinë dhe Reagimin ndaj Emergjencave Shëndetësore (HERA) paraqet një listë prioritarë të 3 kërcënimeve shëndetësore që kërkojnë koordinim në nivel të BE-së për përgatitjen e kundërmasave mjekësore. Bordi i HERA-s ra dakord për një listë që përfshin tre kategori kërcënimesh të potencialit të rrezikshëm për jetën ose të dëmshme, të cilat mund të përhapen në të gjithë Shtetet Anëtare: patogjenë me potencial të lartë pandemik; kërcënimet kimike, biologjike, radiologjike dhe bërthamore; dhe kërcënimet që vijnë nga rezistenca antimikrobike. Stella Kyriakides, Komisionerja për Shëndetin dhe Sigurinë Ushqimore, tha: "Për herë të parë, ne paraqesim kërcënimet kryesore shëndetësore për të cilat duhet të përgatitemi dhe të punojmë për t'iu përgjigjur. Ky

ushttrim është hapi i parë për të siguruar që kundërmasat mjekësore mund të vihen në dispozicion dhe të jenë aksesueshme për të gjitha shtetet anëtare me shpejtësi kur të jetë e nevojshme. HERA është ngritur si kulla jonë e vërtetimit për urgjencat e ardhshme shëndetësore dhe jam i kënaqur që tani po fillon dukshëm ta përmbushë këtë mision. Identifikimi i kërcënimeve kryesore për sigurinë tonë shëndetësore nis procesin për të siguruar zhvillimin, kapacitetin e prodhimit dhe shkallëzimin e prodhimit, prokurimit dhe grumbullimit të mundshëm të produkteve medicinale, diagnostifikimit, pajisjeve mjekësore dhe pajisjeve mbrojtëse personale, si dhe kundërmasave të tjera mjekësore, për të siguruar disponueshmërinë dhe aksesueshmërinë e tyre në rast nevoje."

Lufta e agresionit të Rusisë kundër Ukrainës vazhdon të ndikojë negativisht në ekonominë e BE-së, duke e vendosur atë në rrugën e rritjes më të ulët dhe inflacionit më të lartë në krahasim me parashikimin pranveror. Parashikimi Ekonomik i Verës 2022 (i përkohshëm) parashikon që ekonomia e BE-së do të rritet me 2,7% në 2022 dhe 1,5% në 2023. Rritja në zonën e euros pritet të jetë 2,6% në 2022, duke u zbutur në 1,4% në 2023. Inflacioni mesatar vjetor është parashikuar të arrijë majat historike në vitin 2022, në 7.6% në zonën e euros dhe 8.3% në BE, përpara se të lehtësohet në 2023 në 4.0% dhe 4.6%, respektivisht.

Goditjet e shkakut nga lufta ndikojnë negativisht në rritje

Shumë nga rreziqet negative që rrethojnë Parashikimin e Pranverës 2022 janë materializuar. Pushtimi rus i Ukrainës ka vënë presione shtesë në rritje mbi çmimet e energjisë dhe të mallrave ushqimore. Këto po ushqejnë presionet globale inflacioniste, po gërryejnë fuqinë blerëse të familjeve dhe po shkaktojnë një përgjigje më të shpejtë të politikës monetare sesa supozohej më parë. Ngadalësimi i vazhdueshëm i rritjes në SHBA po shton ndikimin negativ ekonomik të politikës strikte të Kinës me zero-COVID.

Ekonomia e BE-së mbetet veçanërisht e ndjeshme ndaj zhvillimeve në tregjet e energjisë për shkak të varësisë së saj të lartë në lëndët djegëse fosile ruse dhe dobësimi i rritjes globale ul kërkesën e jashtme. Momenti u mbledh me rimëkëmbjen e vitit të kaluar dhe një tremujor i parë disi më i fortë se sa ishte vlerësuar më parë, pritet të mbështesë normën vjetore të rritjes për vitin 2022. Megjithatë, aktiviteti ekonomik në pjesën e mbetur të vitit pritet të jetë i ndrydhur, pavarësisht një turizmi premtues të sezonit veror. Në vitin 2023, rritja ekonomike tremujore pritet të marrë vull, në kurrizin e një tregu elastik të punës, zbutjes së inflacionit, mbështetjes nga Lehtësia e Rimëkëmbjes dhe Rezi-stencës dhe sasisë ende të madhe



Parashikimi ekonomik i verës 2022: Lufta e Rusisë përkeqëson perspektivën

të kursimeve të tepërta.

Në përgjithësi, ekonomia e BE-së do të vazhdojë të zgjerohet, por me një ritëm dukshëm më të ngadaltë se sa pritej në Parashikimin e Pranverës 2022.

Inflacioni, rekord i lartë, pritet të zbutet në vitin 2023

Inflacioni total deri në qershor ka shënuar nivele rekord pasi çmimet e energjisë dhe ushqimeve vazhduan të rriteshin dhe presionet e çmimeve u zgjeruan tek shërbimet dhe mallrat e tjera. Në zonën e euros, inflacioni u rrit fuqishëm në tremujorin e dytë të 2022, nga 7.4% në mars, në një nivel të ri historik prej 8.6% në qershor. Në BE, rritja ishte edhe më e theksuar, me një rritje të plotë të inflacionit, nga 7.8% në mars në 8.8% në maj.

Parashikimi për inflacionin është rishikuar ndjeshëm në rritje krahasuar me parashikimin pranveror. Përveç rritjes së fortë të çmimeve në tremujorin e dytë, një rritje e mëtejshme e çmimeve europiane të gazit pritet të kalojë te konsumatorët edhe nëpërmjet çmimeve të energjisë elektrike. Inflacioni parashikohet të arrijë në 8.4% në vit në tremujorin e tretë të 2022 në eurozonë dhe prej aty të bjerë në mënyrë të qëndrueshme nën 3% në tremujorin

e fundit të 2023, si në eurozonë ashtu edhe në BE, si pasojë e presioneve nga oferta kufizimet dhe çmimet e mallrave zbehen.

Rreziqet mbeten të larta dhe të varura nga lufta

Rreziqet ndaj parashikimit për aktivitetin ekonomik dhe inflacionin varen shumë nga evolucioni i luftës dhe në veçanti nga implikimet e saj për furnizimin me gaz në Europë. Rritjet e reja të çmimeve të gazit mund të nxisin më tej inflacionin dhe të frenojnë rritjen. Efektet e raundit të dytë nga ana e tyre mund të përforcojnë forcat inflacioniste dhe të çojnë në një shtrëngim më të mprehtë të kushteve financiare që jo vetëm do të rëndojnë mbi rritjen ekonomike, por gjithashtu do të vijnë me rreziqe në rritje për stabilitetin financiar. Nuk mund të përjashtohet mundësia që pandemia e ringjallur në BE të sjellë ndërprerje të reja në ekonomi.

Në të njëjtën kohë, tendencat e fundit rënëse të çmimeve të naf-tës dhe të lëndëve të tjera mund të intensifikohen, duke sjellë një rënie më të shpejtë të inflacionit sesa pritej aktualisht. Për më tepër, falë një tregu të fortë pune, konsumi privat mund të tregohet më elastik ndaj rritjes së çmimeve nëse familjet do të përdornin më

shumë nga kursimet e tyre të akumuluar.

Valdis Dombrovskis, Zëvendës President Ekzekutiv për një Ekonomi që funksionon për njerëzit, tha: “Lufta e Rusisë kundër Ukrainës vazhdon të hedhë një hije të gjatë mbi Europën dhe ekonominë tonë. Ne po përballemi me sfida në fronte të shumta nga rritja e çmimeve të energjisë dhe ushqimeve deri te një perspektivë globale shumë e pasigurt. Ne jemi me fat që po fillojmë nga një pozicion i fortë, pasi kemi kaluar krizën e mëparshme me një rikthim solid në rritje. Rritja ekonomike do të ngadalësohet ndjeshëm në pjesën e dytë të këtij viti, por do të fitojë më shumë tërheqje në vitin 2023. Duke pasur parasysh inflacionin e lartë dhe shtrëngimin e kushteve të financimit, do të jetë e rëndësishme të gjendet ekuilibri i duhur midis lëvizjes drejt një qëndrimi më të kujdesshëm fiskal dhe mbrojtjes më të madhe. Ne gjithashtu duhet të zvogëlojmë varësinë tonë nga karburantet fosile ruse.”

Paolo Gentiloni, Komisioneri për Ekonominë tha: “Pushtimi i paprovokuar i Ukrainës nga Rusia vazhdon të dërgojë valë tronditëse në ekonominë globale. Veprimet e Moskës po prishin furnizimet me energji dhe grurë, duke rritur çmimet dhe duke dobësuar besimin. Në Europë, vrulli nga rihapja e ekonomive tona është vendosur të mbështesë rritjen vjetore në vitin 2022, por për vitin 2023 ne kemi rishikuar dukshëm poshtë parashikimin tonë. Inflacioni rekord i lartë tani pritët të arrijë kulmin në fund të këtij viti dhe gradualisht të bjerë në vitin 2023.

Me rrjedhën e luftës dhe besueshmërinë e furnizimeve me gaz të panjohur, ky parashikim është subjekt i pasigurisë së lartë dhe rreziqeve negative. Për të lundruar në këto ujëra të trazuar, Europa duhet të tregojë leadership, me tre fjalë që përcaktojnë politikën tona: solidaritet, qëndrueshmëri dhe siguri.

Parashikimi Ekonomik i Verës 2022 ofron një përditësim të Parashikimit Ekonomik të Pranverës 2022, i cili u prezantua në maj 2022, duke u fokusuar në zhvillimet e PBB-së dhe inflacionit në të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së.

Programi i 8-të i Veprimit për Mjedisin: BE-ja vendos të masë progresin në objektivat e “Marrëveshjes së Gjelbër”

Komisioni prezantoi një listë të treguesve kryesorë për monitorimin e progresit drejt objektivave mjedisore dhe klimatike të BE-së deri në vitin 2030, si dhe vizionin afatgjatë të vitit 2050 për të “jetuar mirë, brenda kufijve planetarë”. Si rezultat i konsultimeve intensive me palët e interesuara dhe Shtetet Anëtare, Korniza e re e Monitorimit në kuadër të Programit të 8-të të Veprimit për Mjedisin synon të nxisë transparencën dhe të informojë europianët për ndikimin e politikës klimatike dhe mjedisore të BE-së.

Politikat e BE-së duhet të sigurojnë që BE-ja të kthehet në rrugën e duhur për të jetuar dhe punuar brenda kufijve planetarë. Si të tillë, treguesit kapin progresin drejt mirëqenies mjedisore, duke përfshirë edhe aspektet ekonomike dhe sociale. Si të tilla, ato mund të hapin rrugën për matjen e shëndetit të ekonomive dhe shoqërive tona bazuar në mirëqenien, dhe përtej treguesit më të njohur ekonomik, PBB-së.

Zëvendës-Presidenti Ekzekutiv Frans Timmermans, i ngarkuar me Marrëveshjen e Gjelbër Europiane, tha: “Ne kemi objektiva shumë ambicioze mjedisore dhe klimatike për të na ndihmuar të realizojmë tranzicionin e drejtë të gjelbër për të cilin ka nevojë Europa dhe bota. Por atë që nuk mund ta matësh, nuk mund ta menaxhosh. Për të na mbajtur në rrugën e duhur, duhet të vëzhgojmë nëse po i përmblushim qëllimet tona. Këta tregues na ndihmojnë ta bëjmë këtë.”

Virginijus Sinkevičius, Komisioneri për Mjedisin, Oqeanet dhe Peshkimin, tha: “Politikat janë po aq të mira sa zbatimi i tyre. Këta tregues kryesorë do të na ndihmojnë të ndjekim politikën e dakorduar sipas Marrëveshjes së Gjelbër Europiane, duke hedhur dritë mbi tendencat dhe duke lehtësuar një diskutim të informuar midis politikëbërësve se ku nevojiten përpjekje të mëtejshme.”

Treguesit kryesorë ndjekin strukturën e Programit të 8-të të Veprimit për Mjedisin, bazuar në Marrëveshjen e Gjelbër Europiane dhe përfshijnë 2-3 treguesit më të rëndësishëm dhe statistikisht të fortë për secilin nga objektivat prioritare tematike deri në vitin 2030, që mbulojnë zbutjen e klimës, përshtatjen klimatike, ekonominë rrethore, zero ndotje dhe biodiversitet.

Përveç kësaj, lista përfshin pesë tregues për të matur progresin drejt adresimit të presioneve kryesore mjedisore dhe klimatike. Në përputhje me objektivat e Marrëveshjes së Gjelbër Europiane, kjo mbulon tranzicionin që duhet të shohim në vitet e ardhshme drejt sistemeve të qëndrueshme për energjinë, industrinë, lëvizshmërinë dhe ushqimin.

Për më tepër, grupi i titullit përfshin tregues për të monitoruar progresin drejt kushteve kryesore mundësuese, duke mbuluar financimin e qëndrueshëm, parimin “ndotësit paguajnë” dhe heqjen graduale të subvencioneve të dëmshme për mjedisin.

Kapitulli i fundit i kuadrit të monitorimit përfshin tregues sistematikë që synojnë të kapin progresin drejt tre dimensioneve të mirëqenies mjedisore, për të mbuluar edhe aspekte ekonomike dhe sociale përtej mbrojtjes së natyrës.

Hapat e ardhshëm

Komisioni do të raportojë çdo vit për progresin e bërë, bazuar në inventarizimin e bërë nga Agjencia Europiane e Mjedisit nga viti 2023 e në vazhdim, me ndihmën e treguesve kryesorë të përzgjedhur. Ky raportim do të lehtësojë një shkëmbim vjetor ndërmjet Komisionit, Shteteve Anëtare dhe Parlamentit Europian që do të mbahet në përputhje me Programin e 8-të të Veprimit Mjedisor.

Për më tepër, Komisioni do të kryejë dy vlerësime të thelluara gjatë jetëgjatësisë së programit - një rishikim afatmesëm në 2024 dhe një vlerësim përfundimtar në 2029.

Komisioni do të vazhdojë të promovojë koherencën midis treguesve kryesorë të Programit të 8-të të Veprimit për Mjedisin dhe mjeteve të tjera të monitorimit ndërsektorial, të tillë si Semestri Europian dhe monitorimi i BE-së mbi Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së.

Programi i 8-të i Veprimit për Mjedisin hyri në fuqi më 2 maj 2022 dhe përfshin një detyrim për Komisionin që të paraqesë një kuadër monitorimi, bazuar në një numër të kufizuar treguesish kryesorë. Këto duhet të përfshijnë, aty ku ka, tregues sistematikë që adresojnë ndërlidhjet konsideratave mjedisore-sociale dhe mjedisore-ekonomike të politikës, respektivisht.

EAP-ja e 8-të synon të përshpejtojë tranzicionin e gjelbër në një mënyrë të drejtë dhe gjithëpërfshirëse, me objektivin afatgjatë të vitit 2050 “Të jetosh mirë, brenda kufijve planetarë”, të vendosur tashmë në programin e 7-të (2014-2020). Për më shumë se 40 vjet, këto programe veprimi i kanë ofruar BE-së korniza politikash që japin rezultate dhe sigurojnë veprim të parashikueshëm dhe të koordinuar për mjedisin dhe politikën e ndryshimeve klimatike të Europës.

Gjeneral Christopher Cavoli, Komandanti i ri Suprem i Aleatëve në Europë

Stoltenberg:
Lideri i duhur,
për postin
e duhur, në
kohën e duhur

Përshtati: Mimoza Golikja

Gjenerali i Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara, Christopher Cavoli mori komandën e Komandës Aleate të Operacioneve në një ceremoni në Shtabin Suprem të Fuqive Aleate në Europë në Mons, Belgjikë më 4 korrik 2022. Gjeneral Cavoli pason gjeneralin Tod Wolters të Forcave Ajrore të SHBA-së, i cili është në këtë detyrë që nga viti 2019. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg kryesoi ceremoninë. Ai përgëzoi gjeneralin Wolters për përkushtimin e tij vetëmohues ndaj Aleancës, përfshirë punën e tij për t'iu përgjigjur pandemisë COVID, tranzicionin e Misionit të Mbështetjes së Vendosur në Afganistan dhe përgjigjen me shpejtësi dhe forcë ndaj pushtimit brutal të Ukrainës nga Rusia. Ai më tej falënderoi gjeneralin Wolters për udhëheqjen e zhvillimit dhe ekzekutimit

të planeve të mbrojtjes së NATO-s të një lloji krejtësisht të ri, që hapi rrugën për vendime transformuese në Samitin e Madridit. "Ti ishe thjesht lideri i duhur, në postin e duhur, në kohën e duhur", - tha Stoltenberg. Si mirënjohje për shërbimin e shquar të gjeneralit Wolters për Aleancën, Sekretari i Përgjithshëm i akordoi atij Medaljen e Shërbimit të Merituar të NATO-s.

Sekretari i Përgjithshëm i uroi mirëseardhjen gjeneralit Cavoli, duke vënë në dukje se karriera e tij ushtarake 35-vjeçare ka qenë e shtrirë në të gjithë globin, nga Bosnja në Irak, Afganistan dhe Uashington, prania e SHBA-së në Europë në dekada, me mbi 100 000 trupa. "Ju bashkoheni me ne në një pikë kthese për sigurinë transatlantike, e shënuar nga konkurrenca strategjike në rritje dhe kthimi i konfliktit brutal në Europë, - tha Stoltenberg. - E di që do të vazhdoni t'i shërbeni NATO-s me të njëjtin leadership dhe përkushtim që keni treguar gjithmonë."

Komanda Aleate e Operacioneve është përgjegjëse për planifikimin dhe ekzekutimin e të gjitha operacioneve të NATO-s. Gjeneral Cavoli është Komandanti Suprem i njëzetë i Aleatëve në Europë (SACEUR). I pari që mori këtë detyrë ishte gjenerali Dwight D. Eisenhower, që më pas do të bëhej Presidenti i 34-të i Shteteve të Bashkuara.

"Tod Wolters, përmbushi detyrën fisnike me nder dhe dallim"

Ceremonia për të nderuar dy udhëheqës të shquar ushtarakë, gjeneralin Tod Wolters, nga Forca Ajrore e Shteteve të Bashkuara dhe gjeneralin Christopher Cavoli, nga Ushtria e Shteteve të Bashkuara, Komandanti aktual dhe ai i ardhshëm Suprem i Aleatëve në Europë, SACEUR, u kryesua nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg.

"Përkushtimi juaj vetëmohues ndaj Aleancës sonë na ka ndihmuar të kalojmë nëpër momente të vështira. Sigurimi që kriza





shëndetësore COVID nuk u shndërrua në krizë sigurie, tranzicioni i Misionit tonë të Mbështetjes Vendimtare në Afganistan dhe duke iu përgjigjur me shpejtësi dhe forcë pushtimit brutal të Ukrainës nga Rusia. Gjithçka duke udhëhequr zhvillimin dhe zbatimin e një plani të mbrojtjes krejtësisht të ri të familjes të NATO-s dhe duke ofruar bujarisht kohën dhe ekspertizën tuaj për ambasadorët, ministrat dhe udhëheqësit e Aleatëve”, - tha Stoltenberg. Ai solli momentet sfiduese për Aleancën nën drejtimin e gjeneralit Tod Wolters. “Ju jeni vërtet një komandant i shekullit të 21-të, i cili ka vendosur një strategji gjithëpërfshirëse dhe të integruar për parandalimin e luftës. Kjo e bën Aleancën tonë më të fortë dhe më të shkathët, tani dhe për të ardhmen.

Së bashku, përballë sfidave dhe mundësive të reja

“E di që do të vazhdoni t’i shërbëni NATO-s me të njëjtin leadership dhe përkushtim që keni treguar gjithmonë”, - tha Sekretari i Përgjithshëm në ceremoninë e marrjes së detyrës nga komandanti i ri gjeneral Cavoli. “Lindur në Gjermani gjatë Luftës së Ftohtë, i rritur në Itali dhe një folës i frëngjishtes, italishtes dhe rusishtes, gjeneral Cavoli ka një lidhje të përjetshme me Europën”, - tha Stoltenberg. Ai tha se karriera e tij ushtarake 35-vjeçare ka qenë e shtrirë në të gjithë globin, nga Bosnja, në Irak dhe Afganistan. Nga komandimi i njësive të këmbësorisë, për rolet strategjike në Uashington...

“Së fundmi, si Komandë e Përgjithshme e Ushtrisë Amerikane për Europën dhe Afrikën, ju keni mbikëqyrur përf forcimin më të madh të pranisë së SHBA-së në Europë në dekada, me mbi 100 000 trupa. Ju keni komanduar

stërvitje të mëdha shumëkombëshe. Kjo tregon gatishmërinë tonë dhe aftësinë tonë për të vepruar pa probleme së bashku. Ju bashkoheni me ne në një pikë kthese për sigurinë transatlantike, e shënuar nga konkurrenca strategjike në rritje dhe kthimi i luftës brutale në Europë.

Gjeneral Christopher Cavoli, Komandanti i 20-të Suprem i Aleatëve në Europë

Gjenerali i Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara, Christopher Cavoli që mori komandën nga gjenerali i Forcave Ajrore të SHBA-së Tod D. Wolters u bë Komandanti i 20-të Suprem i Aleatëve në Europë (SACEUR).

Gjatë mandatit të tij gjenerali Wolters në SHAPE, ndikoi në disa momente kyçe në historinë e NATO-s, siç janë ruajtja e efektivitetit operacional gjatë Pandemisë COVID-19, pjesëmarrjen e ACO-së në Steadfast “Defender 2021”, stërvitjen më të madhe të NATO-s në më shumë se një dekadë, tërheqjen e trupave të NATO-s nga Afganistani dhe mbështetjen e evakuimit të afganëve anëtarë të NATO-s, misioni i vazhdueshëm i NATO-s në Irak, struktura e DDA-së për të kundërshtuar me mirë kërcënimet e mundshme ndaj Aleancës dhe për të siguruar paqen, sigurinë dhe prosperitetin për kombet aleate dhe përgjigjen e aleatëve ndaj pushtimit të vazhdueshëm rus të Ukrainës.

Gjatë fjalimit të tij për ndryshimin e komandës, gjenerali Wolters nga ana e tij, foli për kohën si SACEUR, duke ndarë vlerësimin për ekipin e tij që kishte ecur nëpër disa kërcënime më dinamike të sigurisë të Aleancës të parat në histori. “Për tre vitet e fundit, ju keni derdhur sinqerisht

gjakun, djersën dhe lotët tuaj për të krijuar paqen. Siç tha Sekretari i Përgjithshëm, ne kemi pasur disa sfida të vështira gjatë rrugës. Asnjë nuk ishte shumë i madh dhe asnjë nuk na detyroi të ishim në një pozicion që të dorëzoheshim ndonjëherë. Është për shkak të përpjekjes vendimtare për të gjeneruar paqen që jemi në situatën që jemi sot dhe po punojmë shumë për të përmirësuar kushtet”, - tha Wolters.

Ndërkohë gjeneral Cavoli vjen në SHAPE nga Komanda e Ushtrisë Amerikane për Europën dhe Afrikën në Wiesbaden, ku shërbeu si komandant i Ushtrisë së konsoliduar të SHBA-së për Europën dhe Afrikën, detyrë që e mbajti nga tetori 2020 deri në qershor 2022.

Gjatë ceremonisë, së 4 korrikut, gjeneral Cavoli shprehu mirënjohjen e tij për mundësinë për të drejtuar shtabin më të vjetër ushtarak të NATO-s. “Faleminderit të gjithëve që erdhët këtu sot. Prania juaj na nderon, por më shumë prania juaj ilustron unitetin e kësaj aleance, aleancën më të madhe në historinë e njerëzimit. Është një përfaqësim i lidhjes që na mban të bashkuar” - tha ai.

Pas ceremonisë, Kryetari i Komitetit Ushtarak (CMC), Admirali Rob Bauer shprehu rolin e rëndësishëm të SACEUR si lideri më i lartë ushtarak i NATO-s. “Gjenerali Wolters ka përcjellë SHAPE dhe US EUCOM përmes trazirave të paprecedentë. Me efikasitetin dhe energjinë e tij të pakufishme, ai punoi si me një pamje të gjerë ashtu edhe me detaje mikroskopike. Me punën e tij të pandërprerë në strategjinë tonë ‘të pengojmë dhe mbrojmë’ dhe më pas planet, ai e ka lënë NATO-n më të fortë se sa e ka gjetur. Ai do të mbahet mend si një udhëheqës ushtarak i kohës së luftës me një përzierje të fuqishme intelekti, gjykim të jashtëzakonshëm strategjik, këshilla ushtarake të patëmetë dhe të matur. Si dhe një lider i dhembshurisë, sharmit dhe venave prej çeliku. Të gjithë kemi qenë më të sigurt me të në krye”, - tha Admirali Bauer.

Gjenerali Wolters do të tërhiqet zyrtarisht nga Forcat Ajrore të SHBA-së këtë vit, me mbi dyzet vjet shërbim ushtarak.

Finlanda dhe Suedia përfundojnë bisedimet e anëtarësimit në NATO

Aleatët e NATO-s nënshkruajnë Protokollet e Anëtarësimit për Finlandën dhe Suedinë

Ambasadorët e NATO-s nënshkruan Protokollet e Aderimit për Finlandën dhe Suedinë në selinë e NATO-s, më 5 korrik 2022, në prani të ministrit të Jashtëm Finlandez Pekka Haavisto dhe ministres së Jashtme suedeze Ann Linde. "Ky është me të vërtetë një moment historik, për Finlandën, për Suedinë, për NATO-n dhe për sigurinë tonë të përbashkët. "Pak më shumë se një muaj më parë, Finlanda dhe Suedia dorëzuan letrat zyrtare të aplikimit. Kjo u pasua nga javë të tëra diskutimesh intensive. Kishte shqetësime sigurie që duheshin adresuar dhe ne bëmë atë që bëjmë gjithmonë në NATO. Ne gjetëm gjuhën e përbashkët", - tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, në fjalimin që mbajti në fillimin e ceremonisë së nënshkrimit të Protokolleve të Anëtarësimit me Finlandën dhe Suedinë.

Javën e kaluar në Samitin e Madridit, udhëheqësit e vendeve aleate ranë dakord të ftojnë Finlandën dhe Suedinë për t'u bashkuar me NATO-n pas marrëveshjes së një memorandumit trepalësh midis Turqisë, Finlandës dhe Suedisë. "Sot ne do të nënshkruajmë zyrtarisht protokollet e anëtarësimit. Kjo shënon fillimin e procesit të ratifikimit. Dera e NATO-s mbetet e hapur për demokracitë europiane që janë të gatshme të kontribuojnë



për sigurinë tonë të përbashkët. Kjo është një ditë e mirë për Finlandën dhe Suedinë dhe një ditë e mirë për NATO-n. Me 32 kombe rreth tryezës, ne do të jemi edhe më të fortë dhe njerëzit tanë do të jenë edhe më të sigurt, ndërsa përballemi me krizën më të madhe të sigurisë në dekada", - tha ai.

Finlanda dhe Suedia përfunduan bisedimet e pranimit në selinë e NATO-s në Bruksel, më 4 korrik 2022. Bisedimet u zhvilluan midis zyrtarëve të NATO-s dhe përfaqë-

suesve nga Finlanda dhe Suedia. Delegacioni finlandez u kryesua nga ministri i Jashtëm Pekka Haavisto dhe ministri i Mbrojtjes Antti Kaikkonen, delegacioni suedez u kryesua nga ministria e jashtme Ann Linde. Takimet për secilin vend u kryesuan nga Ndihmës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s për Çështjet Politike dhe Politikën e Sigurisë, Bettina Cadenbach. Nënshkrimi i Protokolleve të Anëtarësimit, më 5 korrik 2022, shënon fillimin e procesit të ratifikimit.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg mori pjesë në një takim të përbashkët të Komitetit të Punëve të Jashtme të Parlamentit European dhe të Nënkomitetit për Sigurinë dhe Mbrojtjen për diskutime mbi vendimet e Samitit të NATO-s dhe mbi bashkëpunimin midis NATO-s dhe Bashkimit European. Duke folur me anëtarët e parlamentit të BE-së, Sekretari i Përgjithshëm e përshkroi Samitin e NATO-s në Madrid si "historik dhe transformues".

Ai tha se Ukraina mund të llogarisë mbështetjen e NATO-s, "për aq kohë sa duhet", sepse një Ukrainë e fortë dhe e pavarur është jetike për sigurinë e zonës euroatlantike dhe për stabilitetin global.

Z. Stoltenberg tha se në Samit aleatët vendosën "rishikimin më të madh në parandalimin dhe mbrojtjen tonë që nga Lufta e Ftohtë" për t'iu përshtatur një realiteti të ri të sigurisë. Aleanca do të forcojë mbrojtjen përpara, do të forcojë grupet e betejës në pjesën lindore të Aleancës, do të rrisë numrin e forcave të gatishmërisë së lartë në mbi 300 000 dhe do të para-pozicionojë pajisjet dhe rezervat e furnizimeve ushtarake.

Duke folur për aplikimin e Finlandës dhe Suedisë për anëtarësim në NATO, ai tha se është mirë për Finlandën, për Suedinë, për NATO-n, për stabilitetin në të gjithë zonën euroatlantike dhe gjithashtu tregon se dera e NATO-s është e hapur. Sekretari i Përgjithshëm theksoi se në Madrid liderët e NATO-s miratuan një Koncept të ri Strategjik. Ai tha se Koncepti Strategjik i NATO-s dhe Busulla Strategjike e BE-së janë dokumente të ndryshme, por ato "pasqyrojnë të njëjtin realitet" në një botë më të rrezikshme, konkurruese dhe të paparashikueshme.

BE dhe NATO,

bashkëpunim në nivel të lartë

Në fjalën e tij në takimin e përbashkët të Komitetit të Punëve të Jashtme të Parlamentit European dhe Nënkomitetit për Sigurinë dhe Mbrojtjen, ku u pasua nga një shkëmbim pikëpamjesh me anëtarët e Parlamentit Eu-

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s në takimin me anëtarët e Parlamentit të BE-së: Koncepti Strategjik i NATO-s dhe Busulla e BE-së, pasqyrojnë të njëjtin realitet



ropian, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, shprehu kënaqësinë e tij për këtë takim për shkëmbim pikëpamjesh të rëndësishme. "Është gjithmonë kënaqësi për mua si Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s të takoj parlamentarët e NATO-s dhe për mua këto angazhime janë një mënyrë për t'u siguruar që ne jemi vazhdimisht duke zhvilluar dhe forcuar bashkëpunimin ndërmjet BE-së dhe NATO-s, menjëherë pas Samitit të NATO-s, -tha ai, -ne patëm një Samit në Madrid vetëm disa ditë më parë. Në atë samit ne ripërsëritëm mbështetjen e fortë në NATO për bashkëpunimin ndërmjet BE-së dhe NATO-s. Në takim morën pjesë si presidentja von der Leyen ashtu edhe presidenti Charles Michel. Ne të gjithë e kuptojmë se BE-ja dhe NATO-ja, jemi dy organizata të ndryshme, por ne ndajmë shumë nga të njëjtat sfida, ne ndajmë të njëjtën fqinjësi dhe punojmë gjithnjë e më shumë së bashku. Ne shohim gjithashtu se në dritën e luftës, krizës, në Ukrainë, sanksioneve ekonomike të vendosura nga BE, e gjithë mbështetja për Ukrainën e dhënë nga Bashkimi European, funksionon shumë mirë krah për krah me përpjekjet

e aleatëve të NATO-s gjithashtu për të vendosur sanksione, por edhe të sigurojë mbështetje të konsiderueshme ushtarake dhe ekonomike për Ukrainën.

Kjo vërtet tregon unitetin e BE-së dhe NATO-s", - tha ai dhe kujtoi dy deklaratat e mëparshme të nëshkruara midis NATO-s dhe BE-së gjatë bashkëpunimit, por dhe për nevojën e një deklarate të tretë. "Kam pasur privilegjin të nënshkruaj një deklaratë të përbashkët për bashkëpunimin NATO-BE (dy herë në fakt), me Presidentin Donald Tusk dhe Presidentin Jean-Claude Juncker dhe tani me von der Leyen, Michel dhe unë kemi rënë dakord që ne duhet të shqyrtojmë deklaratën e tretë. Nuk jam në gjendje t'ju them saktësisht se kur do të mund të kemi një deklaratë të tretë, por kjo është diçka që tani mbështetet nga dy presidentët e BE-së dhe unë, kështu që do të fillojmë të punojmë për këtë sa më shpejt të jetë e mundur. Mendoj se është e dobishme të kemi një deklaratë për të përshkruar prioritetet kryesore dhe gjithashtu për të siguruar që 74 projektet që kemi identifikuar tashmë, se po i ndjekim dhe i zbatojmë ato", -tha ai.

KOLONEL HALIL KATANA, ushtaraku, gazetari dhe qytetari me gjurmë të arta në panteonin e vlerave të FA-së

NGA SALI ONUZI*

Halil Katana ka lindur më 15 dhjetor 1939, në fshatin Degë të Tropojës, në një familje me tradita të shquara atdhetare, me emër në Malësinë e Gjakovës. Stërgjyshi i Halilit, në vitin 1852, kish rënë në luftë për mbrojtjen e trojeve amtare nga ushtria pushtuese malazeze. Gjyshi, Avdyli, kish marrë pjesë në Kuvendin e Junikut dhe ishte bashkuar me forcat kryengritëse të vitit 1910, të komanduara nga Isa Boletini. Babai i Halilit, Mehmeti, më 1912, në krye të burrave të fshatit Degë, kish luftuar në Qafën e Prushit, nën komandën e Bajram Currit.

Familja e Mehmet Katanës dhe vëllezërit e tij e kishin përkrahur Lëvizjen dhe Luftën ANÇ. Hysen Katana, mixha i Halilit, do të rreshtohet partizan në Brigadën e 25 sulmuese dhe do të luftonte në radhët e saj për çlirimin e Kosovës.

Halil Katana, 5 vjeç, mbeti pa nënë Fatimen në dimrin e vitit 1944, në kohën e operacionit gjermano-ballist, të cilët kishin shkuar në Degë për të ndëshkuar banorët e saj pse kishin mbajtur partizanët. Me 1945 do të ndahej nga jeta dhe babai i Halilit, Mehmet Katana. Për Halilin dhe vëllanë e tij më të vogël, u kujdes gjyshja e tyre nga babai, Ajne Sylja, deri në vitin 1947, kur dhe ajo u nda nga jeta. Pas kësaj kohe, nëna e tyre u bë Shkurtë Ademja, gruaja e mixhës së tyre, Haxhiut, që nuk i ndau nga fëmijët e saj. Halili i ka kushtuar një libër të vogël asaj, të shkruar me dashuri të madhe me ngrohtësi e bukuri. Halili është kujdesur për Shkurtën si për nënën e tij, ndonëse ajo kishte katër djem e dy vajza. Disa vite më vonë, më 1956, vdiq edhe vëllai i vetëm më i vogël i Halilit, Avdyli, në moshën 12 vjeçare, nga shpërthimi i një granate të luftës dytë botërore.

Halili e kaloi fëmijërinë në vendlindje, ku kreu shkollën fillore. Shkollën 7-vjeçare e mbaroi në qytetin "Bajram Curri", konviktor me bursë shteti. Mësonte shumë dhe mbaroi shkollën shkëlqyer. Pas kësaj kohe ai do të merrte pjesë në disa aksione vullnetare në moshën



13-vjeçare, më 1952, në hapjen e rrugës së Dritës për hidrocentralin e Matit, në vitin 1955 në kantierin e hidrocentralit të Ulzës, në aksionin e rrugës Shëmbri-Kolgecaj dhe më vonë, si oficer me rininë e ushtrisë, në vitet 1960 në Rrugën e Malësisë së Madhe e më pas në Hekurudhën Elbasan - Përrenjas, në rrugën e Komanit etj.

Pas mbarimit të 7-vjeçares fitoi të drejtën të vijonte mësimet në shkollën ushtarake "Skënderbej" në kryeqytet. Ky ishte një fat i madh për malësorin e ri, ku do të dallohej përsëri. Më 1958 vijon studimet në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve në Tiranë në specialitetin e ndërlidhjes. Për rezultate të larta në mësimet e stërvitje caktohet zëvendëskomandant toge me gradë kapter. Pas mbarimit të Shkollës së Oficerëve me rezultate të shkëlqyera, gradohet toger, siç ishin raste të veçanta.

Oficer i ri, emërohet komandant toge në batalionin

e Ndërlidhjes të Brigadës së Shkodrës. Por pas një muaji rikthehet, po komandant toge, në Shkollën e Bashkuar në Tiranë ku dallohet për disiplinë dhe aftësi komanduese. Mehmet Katana, i biri, inxhinier, e kujton mirë çfarë i ka thënë i ati, Halili. Kur u prishën marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik dhe de fakto edhe me Traktatin e Varshavës, Halilin e thërrasin me urdhër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, për të vënë në punë Radiostacionin e ndërlidhjes që përdornin ushtarakët sovjetikë për ndërlidhje me Traktatin e Varshavës. Ky stacion ndodhej në Petrelë. Detyra ishte që ky stacion të kthehej për ndërlidhje e komunikim për Ushtrinë tonë. Oficeri i ri Halil Katana, ia doli me sukses detyrës së tij. Petrit Dume me këtë rast mburrej me të. Po edhe Halil Katana e kujtonte vazhdimisht gjeneralin, Heroin e Popullit. Madje Halili ishte edhe redaktori i librit për Petrit Dumen, shkruar nga Rustem Haxhia.

Me punë e dije, Halil Katana do të ngjitet shpejt në shkallët e karrierës, komandant kompanie, komandant i batalionit autonom të Qendrës së Ndërlidhjes së Ministrisë së Mbrojtjes. Puna e lidhi me Tiranën dhe do të jetë kryeqyteti ku do të njihet e martohet me shoqen e tij tiranase, Bedrien, me të cilën kaluan bashkë një jetë të mrekullueshme familjare.

Në vitet 1964-1967 vazhdon studimet në Akademinë Ushtarake, të cilën e mbaron me diplomë "Shkëlqyer", të serisë së veçantë. Një fazë e re do të nisë për Halil Katanën, kur ai emërohet pedagog i specialitetit të Ndërlidhjes në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve. I përgatitur me dijet e Shkollave që kish mbaruar dhe i ngritur profesionalisht në detyrat që kish kryer, Halil Katana do të dallohet edhe në detyrën e pedagogut, duke studiuar dhe punuar me pasion e përkushtim. Në këtë kohë Halil Katana përgatit e boton 4 libra për Radioteknikën; ky ishte sinjali se ai tanimë po bëhej një oficer me përvojë që studionte dhe përfitonte nga praktika e stërvitjet ushtarake për t'i kthyer këto në tekste mësimorë e shkencorë.

Në vitin 1981 Katana kalon në shtypin ushtarak si redaktor i Revistës "Për mbrojtjen e Atdheut", më pas "Mbrojtja". Në vitin 1992, me të ashtuquajturën reformë u nxor edhe ai në lirim të parakohshëm, pa asnjë argument, vetëm për bindjet e tij personale. Halil Katana do të fillonte menjëherë nga veprimtaria shoqërore. Bashkë me shkrimtarin e mirënjohur Resul Bedo krijuan Shoqatën "Për të rënë të kombit shqiptar" me organin e tyre "Për Mëmëdhenë". Por më 1996 kjo shoqatë u bashkua me atë të familjeve të Dëshmorëve të Luftës NÇ dhe krijuan Organizatën "Për dëshmorët e luftës ANÇ dhe dëshmorët e tjerë të Atdheut". Katana do të zgjidhej në kryesinë e Këshillit kombëtar të saj dhe do të ishte kryeredaktor i Revistës "Pavdekësia". Më 1997 Katana do të merrte gradën e "Kolonelit" dhe do të rikthehej në Ushtri në Revistën "Mbrojtja" si kryeredaktor i saj. Por, kur në vitin 2000 doli në pension, u rikthye te Organizata kombëtare për Dëshmorët e Atdheut, ku punoi deri sa qe gjallë. Në këtë detyrë Halili e shtoi edhe më shumë numrin e veprimtarëve e të bashkëpunëtorëve. Miqtë e tij të shumtë e prisnin më kënaqësi në të gjitha

anët e Shqipërisë, po edhe në Kosovë, sidomos te Radio "Kosova e Lirë", me të cilën kish bashkëpunuar edhe gjatë luftës së UÇK-së.

Halil Katana ishte një rast i rrallë, në mos i vetëm që kish mbaruar Akademinë ushtarake e punonte në shtypin qendror ushtarak. Përgjithësisht dhe natyrisht, kjo kategori i hynin rrugës së karrierës ushtarake nga Brigada në Korpus (divizion) e Shtab të Përgjithshëm. Dhe ishte normale. Halil Katana kish mbaruar shkëlqyer Akademinë ushtarake, por i hyri shtypit. A nuk kishte mbaruar ai shkëlqyer për Ndërlidhje? Kish qenë edhe komandant i batalionit, edhe pedagog i këtij specialiteti në Shkollën e Bashkuar. Ai mund të bënte karrierë si rrallë kush deri në Shtabin e Përgjithshëm. Po atij, që e dashuronte këtë shërbim të mrekullueshëm, që jep e merr informacion, i qante shpirti për një lloj shërbimi dhe informacioni tjetër, për shtypin, për median e shkruar. Me siguri ai kish shumë përjetime dhe emocione nga jeta në ushtri e para saj dhe donte t'i bënte të njohura ato. Shtypi i jepte mundësi të trajtonte luftërat për liri, pavarësi e çlirim, trimëritë e burrave e të grave të Shqipërisë. Kjo e sundonte shpirtin e tij dhe këtu u vendos deri në fund, duke e ndarë jetën e punën e tij në dy pjesë gati të barabarta, 20 vjet në reparte, Shkollë e Akademi dhe 20 vjet në shtypin ushtarak. Sikur i kish ndarë me dorë! Dhe duhet shënuar se shtypi ushtarak ka përfituar nga ky ushtarak dhe gazetar i talentuar. Ai ishte i pakonkurrueshëm në njohjen e jetës ushtarake, të ushtarit e të oficerit, të komandantit e të komisarit, të shefit të shërbimit e të komandantit të armës. Prandaj Halil Katana i rrinte shumë afër repartit dhe jetës ushtarake, pasi kishte kodin e njohjes e të zbërthimit të saj. Po ai nuk u shkëput as nga studimet universitare, do të bënte dy vjet kurs pasuniversitar në gazetari në Universitetin e Tiranës, në fakultetin e Histori-filologjisë; dhe më pas, edhe kursin njëvjeçar të Filozofisë.

Kishte në shtypin ushtarak djem e vajza gazetarë, që kishin ardhur nga universiteti, nga dega e gazetarisë, e gjuhës shqipe e letërsisë etj. Të gjithë në rolin e tyre, disa kanë shkëlqyer, por nëse kanë zotëruar mendim, teknikë të shkruari e bukuri fraze, Halil Katanën në veçanti e tërhiqte jeta, e vërteta dhe guximi për ta shpallë atë hapur për të gjithë. Besoj se nuk ka pasur që t'ia kenë dalë ta ndalojnë, t'i mbyllin gojën e thajnë dorën. Prandaj, herë pas here ai e kujtonte me dashuri e mall Ndërlidhjen, jetën e oficerit dhe të pedagogut, veprat që kishte shkruar për Radioteknikën. Po edhe ndërlidhja e ndihmoi edhe më tej kolonel Katanën. Në fillim të viteve 2000, ai ishte pajisur me një Laptop shumë të mirë që ia kishte dhuruar i biri, në Itali. Halili ishte një njohës i hollë e entuziast i teknologjisë së informacionit dhe një përdorues mjeshtër i saj. Laptopin nuk e hiqte nga krahu. Pasi mbushej me informacione, atë e gjeje në Bibliotekën Kombëtare, duke hedhur shkrimet për revistën e tij të dashur "Pavdekësia".

Informacionin: ku se kërkonte atë. Aty ku s'ta merrte mendja. Ai ishte një reporter model, për të mbledhur e grumbulluar informacion nga terreni, nga repartet, nga shkollat e shumta ushtarake, etj. Ai solli me plot guxim

në Revistën "Mbrojtja" edhe një rubrikë të shkëlqyer për oficerët, nënoficerët dhe ushtarët që mbrojtën repartet më 1997, disa prej të cilëve kishin rënë në krye të detyrës. Duket e lehtë sot. Po atëherë opinioni ishte kthyer kundër ushtrisë, që kish lënë veten në dorë të anarkistëve e vandalëve, që e shkatërruan bazën e saj materiale dhe organizimin. Sapo filloi kjo rubrikë me heronjtë e dëshmorët e saj, u fut në ushtri edhe një korrent frymëzues, pikërisht ajo që i duhej asaj për të vlerësuar trimat e dëshmorët, po dhe për të ngritur e ringritur ushtrinë tonë, në një kohë rekord, kur drejt trojeve shqiptare po afroheshin retë e zeza të luftës shoviniste të serbomëdhenjve.

Kolonel Katana nuk e kish mbajtur për gjerdan kulturën ushtarake. Ai ishte një intelektual i vërtetë. Ai ishte mjeshtër i organizimit të bisedave rreth tavolinës në redaksi, ose të intervistave. Ai gjithnjë kërkonte të ishte në korrekt të zhvillimeve, të kishte një njohje sa më të thellë të problemeve dhe të kuadrove që duheshin intervistuar apo thirrur në takim. U jepte kohë, u dërgonte pyetjet dhe i dëgjonte me shumë vëmendje. Ja çfarë ka shkruar vetë për këtë aspekt të punës së tij: "Si kryeredaktor i revistës "Mbrojtja" kisha vendosur t'i tërheq në këtë revistë drejtuesit kryesorë të shtetit dhe të Ushtrisë, nëpërmjet intervistave të gjëra problemore, ku ata kishin mundësi të shpalosnin idetë e tyre për ringritjen (e Ushtrisë). Prandaj punoja shumë për hartimin e pyetjeve që do t'u jepja, në mënyrë që t'i orientoja me thelbin e problemeve që duheshin trajtuar prej tyre, në përshtatje me funksionet që kishte secili.

Ai mbante në fokusin e tij sidomos veteranët, me të cilët kishte marrëdhënie të ngrohta. Shumë prej tyre i njihte nga afër. Nxitonte që të vilte prej tyre sa më shumë. Ka mbetur si legjendë artikulli i gjeneralmajorit në pension, Qazim Kapisyzit, për datën e Çlirimit, 29 nëntorin, të cilin po e shkruante për revistën. Aty ku kish vënë pikën e fundit, kish ndërruar jetë! Ata ishin heronj, që nuk përtonin e nuk kursenin as nga jeta e tyre për jetën dhe historinë e Ushtrisë, kur media i kërkonte, i afronte e u jepte mundësi të shkruanin. Halil Katana ishte një shembull në këtë drejtim për kolegët e tij gazetarë.

Halil Katana ishte një drejtues e krijues në shtypin ushtarak. Ai nuk mbyllej në korniza. Ajo që duhej komunikuar sot, ai bënte çmos ta bënte të njohur në kohë. Edhe kur kish ndodhur ndonjëherë, që numri i radhës i revistës "Mbrojtja" kish dalë nga botimi, Halili me shokët e tij gazetarë, nuk prisnin edhe një muaj, përgatishnin dhe çonin në botim një "suplement", me pak faqe për temën aktuale dhe e shpërndanin bashkë me Revistën. E rregullonte këtë punë me drejtorët dhe shefat e financës, dhe me të tjerë. Punëtor i madh, i papajtueshëm me shkrimet e varfra. Mik i vërtetë i autorëve të rinj,

me të cilët mbante lidhje dhe shkëmbente përvojë. Kur vinte re raste të plagjiaturës në ndonjë studim akademik, nuk përtonte t'ia thoshte në sy "autorit" të vërtetat një për një dhe ta kritikonte rreptë. Për të botuar as bëhej fjalë.

Kolonel Katana përdorte metoda pune të shkathëta, si ish njëra sot, nuk ish tjetra nesër, në përputhje me objektin e shkrimit. Kushdo mund ta lexojë në revistën "Pavdekësia", se si me të marrë vesh se këtu apo aty, u kishin hequr shkollave emrat e heronjve dhe dëshmorëve, Halili do gjendej atje, siguronte një njohje të plotë, kërkonte dhe realizonte një intervistë me kryetarin e Bashkisë së asaj kohe, të cilën bashkë dhe problemin ua vinte përpara disa personaliteteve shoqërore të njohur e të respektuar, të cilët me reagimet e tyre ndikonin për mirë në opinionin shoqëror.

Kolonel Katana kishte marrëdhënie shembullore me kolegët e vartësit e tij, gazetarë ose punonjës. Fjalëmbël, vlerësues i drejtë i punës së mirë, mbrojtës i hapur i së vërtetës, dashamirës, bashkëbisedues i këndshëm, që s'lodhej së dëgjuari. Njeri më nivel të lartë kulturor, qytetar model në lagjen ku banonte, ku ish zgjedhur



në detyra të rëndësishme shoqërore, të cilave nuk u bënte "bisht" si disa punonjës të lartë të administratës shtetërore e partiake. Ai ishte kolonel i ushtrisë, por mbi të gjitha ishte një shqiptar atdhetar, njeri dhe qytetar i denjë i vendit të vet, që e donte aq shumë.

Halil Katana është autor i 13 librave, bashkautor në tri dhe ka redaktuar 12 libra të autorëve të tjerë... Pas katër librave për radioteknikën, Katana shkroi e botoi: "Isa Boletini - strateg i luftërave kryengritëse", "Për ata që u kthyen nga lufta fitimtarë", "Në ditët e pranverës së madhe", "Stërvitja e paqes", "Flamuri - kryesimbol i kombit", "Kudusi Lama - gjeneral i luftës". Ai është autor i qindra artikujve studimorë dhe publicistikë në fushën e historisë, të traditave tona kombëtare, sidomos për dëshmorët e heronjtë etj. Halili kishte plane për botime në të ardhmen.

Të gjithë, libra e artikuj, janë shkruar nga një dorë mjeshtri, por janë tre prej tyre, që sipas meje, veçojnë: "Ringritja e Ushtrisë Shqiptare '97-2000", "Tri dimensionet e Luftës Çlirimtare të Kosovës" dhe "Vlaga e kësaj toke".

Në parathënien e librit: "Ringritja e Ushtrisë Shqiptare", gjeneralmajor, prof. dr. Kostaq Karoli shkruan: "Ringritjen e ushtrisë e ka sjellë natyrshëm si një proces organik i ringritjes së shtetit shqiptar dhe mbarë shoqërisë shqiptare, pas krizës së thellë që kishte pësuar... Autori ka meritën që me guxim dhe kurajë hedh dritë mbi ato ngjarje tronditëse dhe, në një plan tjetër tregon punën kolosale të oficerëve për përballimin e kësaj sfide... Ndër këta oficerë, ndofta më i vjetri, bën pjesë edhe vetë autori me një shpirt të paepur atdhetar dhe me përkushtim të rrallë, e ndoqi hap pas hapi tërë procesin e ringritjes, duke qenë i pranishëm në çdo veprimtari kryesore e në çdo njësi të Ushtrisë që nga Saranda në Tropojë. ...Lexuesi në këtë libër do të njohë me emër e mbiemër me qindra oficerë, nënoficerë, ushtarë dhe punonjës që dhanë gjakun, djersën, shpirtin dhe dituritë e tyre për ringritjen e shpejtë të Ushtrisë."

Ringritja e ushtrisë shqiptare ishte një domosdoshmëri urgjente edhe për shkak të ngjarjeve që po i kërcënoheshin Kosovës. Këtë kohë Halili e ka ndjekur me shumë interesim. Më 1998-1999, Halil Katana do të ndodhej rregullisht në Lumë, Has e Tropojë për të ndjekur nga afër ngjarjet. Por mund ta shihje që linte zyrën dhe, në pritje të lajmeve nga Kosova, i shqetësuar bënte ndonjë xhiro në sheshin e Ministrisë së Mbrojtjes, sepse siç thuhet "nuk i zinte vendi vend", duke pritur ndonjë situatë të re nga telefoni satelitor i kuadrove të UÇK-së e burime të tjera. Kështu shkroi shumë artikuj kushtuar kësaj teme. Madje ai ishte i pari që u fut në Kosovë për të takuar, menjëherë pas mbarimit të Luftës, drejtuesit dhe anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së e për të biseduar me to, për të marrë intervista etj. Kishte shkruar për të parë nga afër edhe pozicione të luftës.

Pas fitores kolonel Katana do të botonte në vitin 2002 librin "Tri dimensionet e Luftës Çlirimtare të Kosovës", në parathënien e së cilës ministri i Mbrojtjes (1997-1998) prof. dr. Sabit Brokaj shkruan se Halil Katana ka qenë, në thelb, pjesëmarrës aktiv i kësaj veprimtarie patriotike, politike, organizuese e drejtuese ushtarake. Ai ka qenë në lidhje të ngushtë me ideatorët dhe organizatorët që në fillimet e viteve '90, ka qenë në kontakt me shumicën e drejtuesve të saj gjatë gjithë kësaj lufte, duke përjetuar të gjitha fazat e saj, nëpërmjet informacionesh, këshillash dhe porosish të karakterit politik e ushtarak. Fati e solli që gjatë luftës të jetë kryeredaktor i revistës "Mbrojtja", të cilën e orientoi në dobi të Luftës Çlirimtare të Kosovës, si të ishte organ i saj". Sabit Brokaj me të drejtë shkruante se "libri i Halil Katanës për UÇK-në do të ishte në krye të të gjithë librave që do të botoheshin, sepse është shkruar nga një njohës i shkëlqyer i Historisë sonë kombëtare, nga një patriot, ku dashuria për Kosovën dhe historinë e saj është në majë të penës së tij. Është shkruar nga një ushtarak kompetent dhe publicist e shkrimtar, ku çdo rresht i

shkruar prej tij të jep kënaqësi intelektuale, që provohet jo aq shpesh gjatë leximit në botimet e sotme".

Vepra tjetër, është "Vlaga e kësaj toke", titull që e zgjodhi për të njeriu i madh i kulturës shqiptare, Dritëro Agolli, ish-veteran i Luftës ANÇ. Ky libër është fryt i punës së dy kohëve, vitet 1992-1997, kur Halil Katana ishte shkëputur padrejtësisht, e përkohësisht, fizikisht nga Ushtria dhe e dyta e viteve 2000-2009, kur ai doli në pension pleqërie dhe punoi si kryeredaktor i revistës "Pavdekësia". Në asnjë libër tjetër nuk janë përmbledhur aq bukur punët e mëdha që u bënë në këto vite për themelimin e Organizatës kombëtare për dëshmorët e LANÇ dhe dëshmorët e tjerë të Atdheut, dhe të punës së saj heroike për të përkujtuar dhe ngritur lart Dëshmorët e Atdheut, emrin dhe veprën e të cilëve në këtë kohë guxuan ta marrin nëpër këmbë grupe të caktuara, parti politike e deri qeveri të kohës. Në këtë kohë ndodhnin absurditete e veprime antihistorike. Nëpër bashki e komuna kishte filluar në masë heqja e emrave të heronjve dhe të dëshmorëve nga Shkollat po dhe nga rrugët e sheshet!!! Është kjo kohë kur, me iniciativën e vet, Organizata e familjeve të Dëshmorëve të LANÇ-it filloi nga puna me konsultime të gjera me anëtarësinë e saj për hartimin e projekteve të saj për Statusin e Dëshmorit të Atdheut, që përfundoi në prill të vitit 2000, me miratimin ligjor nga Kuvendi i Republikës me unanimitet të plotë. Libri është një dëshmi e punës së madhe të vetë autorit në mbrojtje të veprës së Dëshmorëve të Atdheut dhe të vlerësimit e përkujtimit të tyre.

Halil Katana u nda nga jeta pas një sëmundjeje të shkurtër e të rëndë, më 16 qershor 2012, ende pa mbushur as 73 vjeç, një dekadë më parë, duke lënë pas të shoqen Bedrien, dy djemtë e tij Ardianin e Mehmetin dhe botimet e tij të shumta, me të cilat ai zë një vend nderi në publicistikën ushtarake dhe atë shqiptare. Halil Katana është dekoruar me disa tituj dhe medalje. Këshilli i Bashkisë së Bajram Currit e ka shpallur atë "Qytetar Nderi" (pas vdekjes), me motivacion "Drejtues dhe pedagog i fushës ushtarake, publicist dhe shkrimtar që gjithë jetën ia përkushtoi Atdheut dhe vlerave të Kombit". Bashkia e qytetit të Gjirokastrës e ka nderuar, më 12 korrik 2012, me titullin "Mirënjohja e qytetit" me motivacion: "Publicist simpatizant, admirues e pasqyrues dinjitoz i patriotizmit të qytetit të Gjirokastrës". Halil Katana është shpallur "Anëtar nderi i Organizatës për dëshmorët e Luftës ANÇ dhe dëshmorët e tjerë të Atdheut". Vepra e tij e plotë pret të studiohet dhe të çmohet siç e meriton.

Me këtë rast falënderoj për bashkëpunimin familjen, të birin Mehmetin, nipin e Halilit, Danjelin dhe nënën e tij prof. Ajshen. Po edhe kryeredaktoren gazetës "Ushtria", zonjën Anjeza Musollari, e cila ma besoi mua këtë artikull përkujtimor për mikun tim të paharruar Halil Katanën.

**Kolonel në pension, anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, drejtor i Edukimit dhe Kulturës së Ushtrisë më 1991-1992 dhe i Departamentit të Veteranëve të Luftës, 1995-2001.*



Fatmir Haxhiu, piktori që jetësoi artin ushtarak në telajot e tij

Piktori Fatmir Haxhiu, lindi më 28 dhjetor të vitit 1927. Ai rrjedh nga një familje e mesme qytetare, patriotike nga qyteti i Përmetit. Në vitin 1930 familja e tij u vendos me banim në qytetin e Tiranës, ku kaloi gjithë jetën deri në ditët e fundit më 10 mars 2001. Kreu shkollën fillore në "Shkollën e Kuqe" një nga shkollat e dëguara me mësues patriotë si Sotir Milto Gura, Sali Morina të cilët qenë të parët që e inkurajuan Fatmirin të vizatonte, duke parë dëshirën e tij për tu bërë piktor. Kreu studimet në shkollën e mesme, në Liceun e Tiranës.

Nga viti 1941, edhe pse ishte një katërmbëdhjetë vjeçar merr

pjesë në rininë komuniste shqiptare të shkollës. Gjatë pushtimit fashist në vitin 1942 përkrah lëvizjen çlirimtare dhe në shtator të vitit 1943 del partizan dhe lufton deri në çlirimin e plotë të Shqipërisë. Në nëntor të vitit 1945 Fatmiri shkon për studime ushtarake në Beograd, ku për 6 muaj mori njohuri të përgjithshme ushtarake dhe pas ndarjes së degëve ai vazhdon studimet në Zagreb në shkollën e artilerisë.

Nga mesi i viteve '50, Fatmir Haxhiu u bë promotori dhe krijuesi i studios së parë ushtarake në Shqipëri, ku u pasua edhe nga piktorë e skulptorë të tjerë të rinj, që sapo kishin mbaruar Liceun Artistik të

Tiranës. Në vitin 1959 për herë të parë merr pjesë në ekspozitën kombëtare të pikturës, ku vlerësohet me çmimin e dytë, i pari vlerësim ky që i dha forcë dhe e inkurajoi për më tej. Për vite me radhë piktori u aktivizua dhe me vizatime e grafika në revistën "10korriku".

Të shumta janë tregimet nga lufta që ai ka ilustruar duke ju shtuar atyre emocion dramatik, si në gazetën "Luftëtari", në organe të tjera të shtypit, të shtëpisë botuese "Naim Frashëri", etj.

Edhe pse me punën e talentin e tij ai kishte arritur diçka, dëshira për të vazhduar studimet e larta për pikturë e ngacmonte vazhdimisht. Në vitin 1959 në Institutin e Lartë të

Arteve pas përfundimit të konkursit u pranuan të ndjekin studimet 7 studentë nga 70 kandidatë të paraqitur. Njëri prej fituesve që edhe Fatmiri. Kështu ai fillon studimet të cilat i përfundon me rezultatin shkëlqyeshëm në vitin 1965.

Punimi i tij për diplomën ishte kompozimi me temë nga lufta Nacionalçlirimtare "Kalimi i Divizionit të Parë në Veri" (200x300 cm). Studentit Haxhiu iu desh të bënte një punë kolosale, ai studioi gjatë lidhur me armatimin e pajisjet, veshjet, zgjedhjen e peizazhit, të gjitha këto për të arritur një shkallë sa më të lartë vërtetësie historike. Në të njëjtën kohë ai mundi të interpretoje artistikisht në vepër heroizmin dhe sakrificën që dallonte heronjtë e luftës. Tabloja e tij e diplomës është regjistruar në historikun ende të pashkruar të shkollës së lartë të artit, si një ndër arritjet më të shkëlqyera.

ema e luftës dhe qëndresa heroike e popullit shqiptar në shekuj do të bëheshin motivi kryesor i tërë krijimtarisë së artistit.

Edhe pasi u diplomua ai vazhdoi të punojë si kuadër ushtrie, duke kryer detyra me përgjegjësi të ndryshme në Ministrinë e Mbrojtjes me gradë deri në Nënkolonel.

Krahas funksioneve në ushtri ai vazhdonte punën edhe në atelie, Fatmiri ka qenë një artist i angazhuar edhe në problemet e drejtimit në strukturat e shoqatave artistike. Ka qenë anëtar i Kryesisë së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve nga viti 1966-69 dhe anëtar i Komitetit Drejtues të saj deri në vitin 1991. Gjithashtu ai ka qenë anëtar i komisionit të pikturës pranë Komisionit Shtetëror për Artet Figurative të Shqipërisë, kryetar i komisionit të pikturës pranë Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve dhe anëtar i këshillit artistik të Galerisë Kombëtare të Arteve. Aktiviteti artistik i Fatmir Haxhiut është i ndërthurur edhe me atë pedagogjik, ku ai për vite me radhë ka kontribuar për diplomimin e brezave të rinj të piktorëve me emër. Nga viti 1970-1982 ka qenë pedagog i jashtëm i Institutit të Lartë të Arteve në atelienë e pikturës monumentale për kurset e III-ta dhe të IV-ta. Nga viti 1967 ka

ushtuar krijimtarinë e tij duke qenë në profesion të lirë.

Në këto katër dekada pune të palodhur në fushën e pikturës, ka realizuar një numër të madh veprash në gjininë e kavaletit dhe asaj monumentale. Sot punimet e tij gjenden kudo brenda dhe jashtë vendit. Ato janë ekspozuar apo janë pronë e Galerisë Kombëtare të Arteve, Muzeut Historik Kombëtar, Muzeut Historik të qytetit të Tropojës, Burrelit, Vlorës, Përmetit, si dhe në institucione të tjera social-kulturore. Gjithashtu shtrirja e punimeve jashtë atdheut është e gjerë dhe e admirueshme. Punimet ndodhen në koleksionet private të artdashësve në Itali, Francë, Spanjë, Austri, Greqi, Japoni, Kinë, Rusi, Amerikë, Zvicër, Hungari, Turqi,

riprodhimi të veçanta, katalogë ekspozitash, në pulla filatelie shqiptare dhe të huaja, etj.

Ai i përket atij brezi piktorësh, që bënë epokë në gjysmën e dytë të shek. XX. Fatmir Haxhiu i qëndroi besnik parimeve të tij krijuese: realizmit dhe pasqyrimin me vërtetësi të momenteve kyçe të historisë sonë kombëtare. Nuk është i rastit fakti që ai iu përkushtua me aq pasion punës së tij krijuese, duke na lënë vepra të nivelit evropian. Përpara pikturave të Fatmir Haxhiut ndjen jo vetëm emocione, por edhe dinamizëm të brendshëm, lëvizje, nerv, "zhurmë", zëra njerëzorë, thirrje luftarake, grahamat e fundit të atyre që bien në fushëbeteja.

Atje është bota e trazuar shqiptare



Jugosllavi, Australi, etj.

Në konkurset kombëtare prej vitit 1966 deri në vitin 1990 ka fituar tre çmime të para, dy çmime të dyta dhe një çmim të tretë. Është laureat i Çmimit të Republikës së shkallës parë me veprën "Skroskë 1944" (206 x 330cm), si dhe i Çmimit të Republikës së shkallës së tretë për veprën "Me shpatë në dorë" (550 x 450cm).

Shumë vepra të krijimtarisë së tij janë popullarizuar nëpërmjet botimeve në organe të ndryshme të shtypit si në gazetatat "Drita", "Zëri i popullit", "Puna", "Bashkimi", "Zëri i rinisë", "Luftëtari", në revistat "Albania", "Nëntori", "Ylli", "Shqipëtarja e Re", "10 korriku", "Në shërbim të popullit", "Rruga e Partisë", në revista ushtarakopolitike, në kopertina librash, albume, tekste shkollore, kartolina, fletë

e ballkanase, por dhe bota e trazuar e vetë piktorit.

Fatmir Haxhiu, ishte ai identiteti art-krijues, me shumë vlerësime ndaj figurës së tij si "Piktor i Merituar" dhe "Mjeshtër i Madh i Punës" në këto vite të ikjes ka lënë pas një emër që renditet në fondin e artit të traditës së pikturës shqiptare. Duket sikur gjithçka po merr flakë, ngjyra të ndezura, ngjyra të zhurmshme, ngjyra që flasin. Shkëmbinjtë të thepisur, në një tokë të zhuritur... Malësorë dhe trima shqiptarë që luftojnë e vriten për paqe kundër serbëve.

Pas një pune kolosale në krijimin e qindra tablove sidomos me përmbajtje nga historia kombëtare, piktori i madh shqiptar Fatmir Haxhiu ndërroi jetë më 10 mars të vitit 2001, në Tiranë.

Besimi në informacionin e rremë është një shqetësim i shëndetit mendor

Është lajm i rremë ("fake") apo "fakt"? Faktet mund t'ju duken dëshpëruese, por nëse keni probleme të shëndetit mendor si ankthi dhe depresioni, jeni më të prirur të besoni atë çfarë është e rreme.

Një studim ka zbuluar se njerëzit që besojnë në informacione të rreme për pandeminë e koronavirusit kanë më shumë gjasa të vuajnë nga simptomat e ankthit dhe depresionit.

"Studimi ynë tregon ndikimin e mundshëm negativ të besimeve të rreme rreth COVID-19 në shëndetin mendor", - thotë studiuesi kryesor i studimit, Pawel Debski.

Por studimi nuk tregon se simptomat e depresionit dhe ankthit drejtojnë drejtpërdrejt besimin në informacionin e rremë. As nuk jep shpjegime se si besimi në informacionin e rremë mund të shkaktojë vështirësi në shëndetin mendor.

Informacioni i rremë është dëshpërues

Duke përdorur dy pyetësorë në internet: "Shkalla e Besimeve Konspirative COVID-19" dhe "Shkalla e Ankthit dhe Depresionit Spitalor", studiuesit kërkuan korrelacione midis besimeve të rreme dhe kushteve të shëndetit mendor.

Ata thonë se zbuluan se besimet e zakonshme të rreme për pandeminë përfshinin idetë se qeveritë e ekzagjeruan numrin e vdekjeve nga COVID-19, se 5G përhap koronavirusin dhe se mbajtja e një maske shkakton mungesë oksigjeni dhe helmim nga dioksidi i karbonit.

Pandemia goditi rëndë shëndetin mendor

Ekspertët e kanë përshkruar pandeminë si një krizë në shëndetin mendor.

Organizata Botërore e Shëndetësisë raporton se çështjet e shëndetit mendor u rritën në të gjithë botën për shkak të koronavirusit dhe kufizimeve të sjella për të frenuar përhapjen, siç janë bllokimet dhe karantinimet.

Hulumtimi i ri lidh besimin në lajmet e rreme për COVID-19 me ankthin dhe depresionin. A mundet që kujdesi më i mirë për shëndetin mendor të zvogëlojë përhapjen e informacionit të rremë?

Depresioni dhe ankthi u rritën me 25% në vitin e parë të pandemisë, me të rinjtë dhe gratë që shfaqnin rritjen më të madhe të simptomave.

Thuhej se izolimi social dhe ankthi për shëndetin e dikujt dhe të të dashurve ishin ndër faktorët më të mëdhenj të stresit. Punëtorët kryesorë si profesionistët e kujdesit shëndetësor përmendën gjithashtu gjendjen e lodhjes së skajshme si ndikim në shëndetin e tyre mendor.

Dhe ata thonë se zbuluan gjithashtu se depresioni kishte një lidhje të lartë me besimin në informacionin e rremë për pandeminë, ndërsa ankthi ishte i lidhur më mesatarisht.

Studimi sugjeroi korrelacione të larta midis besimit në informacionin e rremë pandemik dhe besimit në teoritë më të gjera të konspiracionit.



Hulumtimet nga shoqata bamirëse e shëndetit mendor, me bazë në Mbretërinë e Bashkuar, "Mind", sugjerojnë se njerëzit që luftuan me shëndetin e tyre mendor përpara fillimit të pandemisë ishin më të prekur nga kufizimet dhe bllokimet.

A janë mediat sociale fajtores për lajmet e rreme rreth COVID-19?

Më shumë se gjysma e europianëve besojnë se janë ekspozuar ndaj dezinformatave në internet, sipas një raporti të publikuar nga Komisioni European.

Pandemia pa përdorimin e mediave online dhe sociale në nivelet më të larta të të gjitha kohërave, sipas hulumtimit nga "Statista", dhe një studim në revistën "Science" sugjeron që informacioni i rremë arrin më shumë njerëz sesa informacioni faktik në mediat sociale.

Është një fenomen që psikologët e quajnë "paragjykim negativ". Ndodh kur njerëzit përqendrohen në atë që është potencialisht e dëmshme dhe jo në atë që është e dobishme.

Dhe teoria është se përqendrimi në informacione negative i përkeqëson simptomat e depresionit, dhe kjo nga ana tjetër nxit besimin e mëtejshëm në informacionin e rremë.

Mbështetja e shëndetit mendor nevojitet për t'i mbajtur gjërat faktike

Studimi sugjeron se besimi në teoritë e konspiracionit u bën thirrje njerëzve, nevojat kryesore psikologjike të të cilëve janë të paplotësuara, siç

është ndjenja e kontrollit mbi jetën e dikujt. Për shembull, njerëzit që ndihen të pafuqishëm në jetën e tyre mund të përdorin informacion të rremë si një mënyrë për të kontrolluar atë që besojnë.

"Ne mendojmë se besimi në informacionin e rremë kontribuon në një ndjenjë të dobësuar sigurie, duke shkaktuar zhvillimin e ankthit dhe depresionit", -thotë Debski.

Por, sipas shoqatës "Mind", mbështetja e njerëzve me informacion të besueshëm për vetë shëndetin mendor do të ndihmonte.

"Ne hasim shumë keqkuptime rreth shëndetit mendor çdo ditë në media dhe në internet", - thotë zëdhënësi i Mind, Stephen Buckley. "Trajtimi i qëndrimeve negative është çelësi për reduktimin e stigmës, e cila mund të ndihmojë për të luajtur një rol në adresimin e izolimit social dhe ndjeshmërisë së mundshme ndaj lajmeve të rreme."

Pra, mbështetja e njerëzve përmes çështjeve të shëndetit mendor mund t'i ndihmojë ata të ndërtojnë besim në informacionin faktik.

Dhe kjo mund të jetë veçanërisht e vërtetë, thotë Buckley, për njerëzit me prejardhje etnike të zezë dhe të pakicave, ose njerëzit që jetojnë në varfëri, të cilët kanë gati dy herë më shumë gjasa të përdorin komunitetet në internet për të marrë informacion rreth shëndetit të tyre mendor. Është thelbësore që ne t'i sigurojmë që këto hapësira të jenë të sigurta, të besueshme dhe me reputacion."

“James Webb” i NASA-s zbulon shkëmbinjtë kozmikë, peizazhin vezullues të lindjes së yjeve

Ky peizazh “malesh” dhe “luginash” të njollosura me yje vezullues është në të vërtetë skaji i një rajoni yjeformues aty pranë të quajtur NGC 3324 në mjegullnajën Carina. I kapur në dritën infra të kuqe nga teleskopi i ri hapësinor James Webb i NASA-s, ky imazh zbulon për herë të parë zona të padukshme më parë të lindjes së yjeve.

Të quajtur Shkëmbinjtë Kozmikë, fotografia në dukje tre-dimensionale e Uebit duket si male të thepisura në një mbrëmje me hënë. Në realitet, është skaji i zgavrës gjigante, të gaztë brenda NGC 3324, dhe “majat” më të larta në këtë imazh janë rreth 7 vite dritë të larta. Zona e kavernave është gdhendur nga mjegullnaja nga rrezatimi intensiv ultravjollcë dhe erërat yjore nga yjet jashtëzakonisht masivë, të nxehtë dhe të rinj të vendosur në qendër të fluskës, mbi zonën e treguar në këtë imazh.

Rrezatimi fluskues ultravjollcë nga yjet e rinj po skalit murin e mjegullnajës duke e gërryer ngadalë. Shtyllat gjigande ngrihen mbi murin e ndezur të gazit, duke i rezistuar këtij rrezatimi. “Avulli” që duket se ngrihet nga “malet” qiellore është në të vërtetë gaz i nxehtë, jonizues dhe pluhur i nxehtë që largohet nga mjegullnaja për shkak të rrezatimit të vazhdueshëm.


“Webb-i” zbulon çerdhe yjore në zhvillim dhe yje individualë që janë plotësisht të fshehur në fotot e dritës së dukshme. Për shkak të ndjeshmërisë së “Webb-it” ndaj dritës infra të kuqe, ai mund të shikojë përmes pluhurit kozmik për të parë këto objekte. Rrymat protoyjore, të cilat shfaqen qartë në këtë imazh, dalin nga disa prej këtyre yjeve të rinj. Burimet më të reja shfaqen si pika të kuqe në zonën e errët dhe me pluhur të resë. Objektet në fazat më të hershme e të shpejta të formimit të yjeve janë të vështira për t’u kapur, por ndjeshmëria ekstreme e “Webb-it”, rezolucioni hapësinor dhe aftësia e imazhit mund të përshkruajnë këto ngjarje të pakapshme.

Këto vëzhgime të NGC 3324 do të hedhin dritë mbi procesin e formimit të yjeve. Lindja e yjeve përhapet me kalimin e kohës, e shkaktuar nga zgjerimi i zgavrës së

gërryerjes. Ndërsa skaji i ndritshëm, i jonizuar lëviz në mjegullnajë, ai ngadalë shtyhet në gaz dhe pluhur. Nëse skaji ndeshet me ndonjë material të paqëndrueshëm, presioni i shtuar do të shkaktojë që materiali të shembet dhe të formojë yje të rinj.

Në të kundërt, ky lloj shqetësimi mund të parandalojë gjithashtu formimin e yjeve pasi materiali i krijimit të yjeve gërryhet. Ky është një ekuilibër shumë delikat midis formimit të yjeve të ndezjes dhe ndalimit të tij. Webb do të trajtojë disa nga pyetjet e mëdha dhe të hapura të astrofizikës moderne: Çfarë e përcakton numrin e yjeve që formohen në një rajon të caktuar? Pse yjet formohen me një masë të caktuar?

“Webb-i” do të zbulojë gjithashtu ndikimin e formimit të yjeve në evolucionin e reve gjigante të gazit dhe pluhurit. Ndërsa efekti i yjeve masive – me erërat e tyre të dhunshme dhe energjinë e lartë – është shpesh i dukshëm, dihet më pak për ndikimin e yjeve më të shumtë me masë të ulët. Ndërsa formohen, këta yje më të vegjël krijojnë ngushtica kundër rrymave që mund shihen këtu,





Imazhi nga: NASA, ESA, CSA dhe STScI

të cilët mund të injektojnë shumë vrull dhe energji në retë. Kjo redukton fraksionin e materialit mjegullnajës që mbjell yje të rinj.

Deri në këtë pikë, shkencëtarët kanë pasur shumë pak të dhëna për ndikimin e morisë së yjeve të rinj dhe më energjike me masë të ulët. Me "Webb-in", ata do të jenë në gjendje të marrin një regjistrim të plotë të numrit dhe ndikimit të tyre në të gjithë mjegullnajën.

I vendosur afërsisht 7 600 vite dritë larg, NGC 3324 u fotografua nga kamera me infra të kuqe afër (NIRCam) dhe Instrumenti me infra të kuqe të mesme (MIRI) të "Webb-it".

NIRCam, me rezolucionin e tij të qartë dhe ndjeshmërinë e pashembullt, zbulon qindra yje të fshehur më parë, madje edhe galaktika të shumta në sfond.

Në këndvështrimin e MIRI-t, yjet e rinj dhe disqet e tyre me pluhur, që formojnë planetë, shkëlqejnë fort në infra të kuqe në mes, duke u shfaqur rozë dhe e kuqe. MIRI zbulon strukturat që janë të ngulitura në pluhur dhe zbulon burimet yjore të avionëve dhe rrjedhjeve masive. Me MIRI, pluhuri i nxehtë, hidrokarburet dhe përbërjet e tjera kimike në sipërfaqen e kreshtave shkëlqejnë, duke dhënë pamjen e shkëmbinjve të dhëmbëzuar.

NGC 3324 u katalogua për herë të parë nga James Dunlop në 1826. I dukshëm nga hemisfera jugore, ai ndodhet në cepin veriperëndimor të Mjegullnajës "Carina" (NGC 3372), e cila gjendet në yjësine "Carina". Mjegullnaja "Carina" është shtëpia e Mjegullnajës së "Vrimës së Çelësit" dhe yllit super-gjigant aktiv e të paqëndrueshëm të quajtur "Eta Carinae".

Teleskopi Hapësinor "James Webb" është observatori

kryesor i shkencës hapësinore në botë. "Webb" do të zgjidhë misteret në sistemin tonë diellor, do të shikojë përtej botëve të largëta rreth yjeve të tjerë dhe do të hetojë strukturat dhe origjinën misterioze të universit tonë dhe vendin tonë në të. "Webb" është një program ndërkombëtar i udhëhequr nga NASA me partnerët e saj, ESA (Agjencia Europiane e Hapësirës) dhe CSA (Agjencia Kanadeze e Hapësirës).

Selia e NASA-s mbikëqyr misionin për Drejtorinë e Misionit Shkencës të agjencisë. Qendra e Fluturimeve Hapësinore "Goddard" e NASA-s në Greenbelt, Maryland, menaxhon "Webb-in" për agjencinë dhe mbikëqyr punën në misionin e kryer nga Instituti Shkencor i Teleskopit Hapësinor, "Northrop Grumman" dhe partnerët e tjerë të misionit. Përveç "Goddard", disa qendra të NASA-s kontribuan në projekt, duke përfshirë Qendrën Hapësinore "Johnson" të agjencisë në "Houston"; "Jet Propulsion Laboratory" (JPL) në Kaliforninë Jugore; Qendra e Fluturimit Hapësinor "Marshall" në Huntsville, Alabama; Qendra Kërkimore "Ames" në Silicon Valley të Kalifornisë; dhe të tjerët.

NIRCam u ndërtua nga një ekip në Universitetin e Arizonës dhe në Qendrën e Teknologjisë së Avancuar të "Lockheed Martin".

MIRI u kontribua nga ESA dhe NASA, me instrumentin e projektuar dhe ndërtuar nga një konsorcium institutesh europiane të financuara në nivel kombëtar (Konsorciumi European MIRI) në partneritet me JPL dhe Universitetin e Arizonës.

Njerëz, planeti në duart tona!

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Toka jonë është një planet unik në univers, shtëpia jonë e vetme. Çdo person duhet të kujdeset për mjedisin dhe të mos shpresojë për një tjetër.

Ekologjia e tokës çdo ditë vuan më shumë dhe më fortë, bimët e reja janë ndërtuar, gjithnjë e më shumë makina shfaqen në rrugë, raketa dhe satelitë janë nisur në hapësirë. Kjo çon në ndotjen e ajrit, ngrohjen globale dhe duke shkrië akullnajat shfaqen vrmat e ozonit. Të gjitha llojet e kafshëve për shkak të prerjes së pyjeve, shumë gjitarë ujorë dhe peshqit janë kërcënuar prej kohësh me zhdukje për shkak të kontaminimit të ujërave.

Në qytetet e mëdha, njerëzit vuajnë nga sëmundje të traktit të frymëmarrjes dhe kjo për shkak të ekologjisë së bastarduar nga dora njerëzore.

Pas qytetit grumbujt e mbeturinave rriten, sepse paketat dhe shishet nuk përpunohen. Këto "gjëra të vogla", për të cilat nuk mendojmë, çojnë në riprodhimin e brejtësve dhe shfaqjen e sëmundjeve të reja.

Për të mbrojtur tokën tonë nga vdekja, të gjithë duhet të fillojnë me veten, para së gjithash duhet të jetë qëndrim i kujdesshëm për natyrën, bimët që na japin ajër duhen trajtuar me "dashurinë e një fëmije" që jeta të marrë frymë.

Nëse të gjithë shikojnë veten dhe kujtojmë se sa dëm i kemi shkak-



tuar natyrës, dhe pas kësaj do të përpiqet të jetë më i mençur dhe të kujdesshëm, atëherë "planeti blu" do të ekzistojë pa deformime.

Jeta njerëzore është e lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me natyrën, me tokën. Toka është "shtylla kurrizore" pa të cilën nuk do mund të qëndronte njerëzimi në formatin e sotëm. Një person jeton dhe shqetësohet mbi të, ndan me të gëzimin dhe pikëllimin e saj.

Për shumë prej nesh, koncepti i tokës është i lidhur me shtëpinë, me të afërmit, me një lumë, ku kaloi fëmijërinë, duart, lodrat, përralla, rrugë, bar, pyje, retë në qiell dhe shumë-shumë më tepër, është ideja jonë e parë e tokës amtare, për një botë të madhe komplekse.

Ne jemi pronarët e tokës, pronarët e të gjithë të gjallëve që dekorojnë jetën tonë. Por nëse jemi pronarë, atëherë duhet të jemi dhe mbrojtësit e saj, sepse është e pamundur vetëm të posedojmë, duke

mos paguar për ekzistencën unike të saj.

Për disa arsye, bëhet shumë e dhimbshme, sa njerëz e braktisën vendin, duke i dhënë konfuzion të gjithë "dëmtuesve" të mundshëm, termocentraleve bërthamore, bimë pa shpirt...

Ju shikoni fushat e braktitura, kasollet e shkatërruara në fshatra, tharjen e lumenjve dhe madje edhe detet e tërë. Peshqit dhe kafshët vdesin kudo, zhduken nga fytyra e tokës së bimës, ajri i pastër zhduket diku. Dhe shirat e acidit janë derdhur në tokë, dhe shfaqen vrmat e reja të ozonit dhe për disa arsye rriten luleshtrydhe ose patate gjigande.

Planeti ynë sikur nxori një maskë të tmerrshme

Sa dhimbje i japin njerëzit e saj pa shpirt, duke krijuar punët e panjohura!

Toka të ushqen me bukë, ujë të pastër, të befason me bukurinë e saj, por a mjafton kjo për tu ndier

zotë të saj?

Sot, një nga problemet e rëndësishme është kërcënimi i një katastrofe ekologjike.

Ne përjashtojmë indiferencën, ne justifikojmë punësimin, miopinë dhe shumë arsye të tjera që janë të kuptueshme vetëm për ne, dhe në asnjë mënyrë për natyrën tonë. Ne po fillojmë të jemi të zemëruar, kur çdo vit bëhet gjithnjë e më pak hapësirë për rekreacion, sepse lumenjtë, liqenet dhe deti janë të ndotura. Pastaj fillon të vlijë ndërjegjen e zgjuar publike dhe ne jemi të indinjuar kur vendet për peshkim zhduken.

Por, në fund të fundit, ne të gjithë më shumë harrojmë të heqim zjarrin në pyll, përmes të cilit më së shumti mbjelljet e gjelbra zhduken, ne derdhim një numër në rritje të deodorantëve që gjatë viteve reduktojmë shtresën e ozonit.

Njerëz, zgjohuni, shikoni prapa, planeti ynë po vdes!

Unë bërtas për të, sepse ai dëshiron të jetojë për t'ju dhënë dashurinë e tij, ngrohtësinë e tij, ujin e tij, oksigjenin e tij... dëgjoni, përgjigjuni për praninë e tij të dëshpëruar.

Bëni diçka! Jini pronarët e fatit tuaj, pasardhësit e vërtetë të një lloji!

Ndaloni shkatërrimin e të gjitha jetëve, sepse po shkatërroni veten me duart tuaja.

Veprimet tona, veçanërisht varësia jonë nga lëndët djegëse fosile dhe konsumi i lëndëve materiale, po nxisin ndryshimin e klimës, shkatërrimin e ajrit, ujit dhe degradimin e tokës. Ne po prishim ekuilibrat e vetë sistemeve që na duhen për të mbijetuar, e këtë po e bëjmë me shpejtësi dhe ritëm të pashembullt. Zhvillimi i qëndrueshëm njerëzor ka të bëjë me aftësimin e njerëzve për të jetuar në potencial të plotë dhe në mënyra të drejta mjedisore.

Çfarë bëme në shekullin e XXI?! Çfarë ndodhi me ekologjinë e tokës?!

Pyjet u dogjën, lumenjtë u tkurrën. Nuk mund ta bëjmë këtë! Nuk mund të prishim ujërat e brendshëm! Nuk mund të ndërtonte mbi bimë në qytete!

Si mund të jetojmë kështu!?

Jetojmë pa kataklizma teknike,

duke mos rrezikuar të vdesim në tym.

Me ujë të padëmshëm për trupin...

Lëvizni njerëzit, si të mendojmë për njerëzimin, nga gazrat të mos vdesë.

Secili prej nesh duhet të jetë jo vetëm pronari i tokës, por edhe besimtar i saj...

Humanët nuk duhet të luftojnë me natyrën që ajo mos të kthehet në armik për të.

Qëndrimi ndaj natyrës është një nga treguesit kulturorë. Gjithkush është i detyruar të kujdeset për natyrën dhe mjedisin. Njeriu dhe natyra janë të lidhura me njëri-tjetrin.



Pjesëmarrja inteligjente e një personi në jetën e natyrës është e dobishme si për frymorët dhe natyrën, lumenjtë e pastër dhe pyjet e pasura, kafshët dhe zogjtë, toka pjellore dhe uji i pastër janë të nevojshëm për vazhdimin pa trauma të jetës mbi tokë.

Detyra jonë është të shpëtojmë pasurinë e natyrës për të ardhmen. Konsumi, qëndrimi i pamenduar ndaj natyrës nuk do të na falë pasardhësit e ardhshëm.

Gjithkush duhet të mendojë për faktin se natyra mund të shpëtohet vetëm kur të jemi të vetëdijshëm për të vërtetën e thjeshtë: duke bërë dëm për mjedisin, dëmtojmë veten.

Nëna natyrë është unike dhe ideale, ajo mund të jetë e vështirë dhe madje edhe e dhunshme me ne në rastet kur harrojmë faktin se ne jemi vetëm një pjesë e saj.

E egër, e fortë, ajo mund të shkatërrojë të gjithë njerëzimin në një sekondë. Kur e krahasojmë historinë tonë me historinë e Tokës, do të

shohim se koha e njerëzimit është e vetmja e dytë për planetin tonë. Ne nuk jemi mbretër, zotët e natyrës. Ne jemi vetëm fëmijët e saj të këqij.

Ne nuk jemi vetëm pjesë e natyrës në një kuptim të tillë global. Ne jemi pjesë e natyrës sonë lokale, të shtëpisë sonë të vogël. Vendi im, qyteti im, shtëpia ime është shtëpia ime. Familja ime është shtëpia ime. Dhe natyra e egër jashtë është edhe shtëpia ime.

Bota jonë është shtëpia jonë dhe ne jemi përgjegjës për të, sepse ne kemi një fuqi për ta shkatërruar atë. Mund të jetë një shtëpi komode, e bukur, ose mund të jetë një shkretëtirë e pafatë.

Unë jam e frikësuar nga mendimi se ne kemi kaq shumë fuqi, është e tmerrshme. Disa raketa të vogla bërthamore mund të shfatosin planetin tonë, ato kanë një mundësi për të shkatërruar shtëpinë tonë, lumin tonë të bukur, muzgun tonë dhe ne vetë.

Unë e dua shtëpinë time, familjen time, lulet e oborrit tim, cicërimat e zogjve agimeve të bardha. Nëse duam të mbrojmë jetën, duhet të jemi qytetar i përgjegjshëm, fëmijë i bukur i natyrës, "njeri". Bomba atomike shpërthyesë ushtarake goditën qytetet e Hiroshimës dhe Nagasakit në vitin 1945. Lufta e vërtetë ekologjike është e njohur për shitje.

Ajo është kryer gjithashtu nga amerikanët në Indokita, ku shumë njerëz u helmuan nga Yadochimikati. Dhe megjithatë plagët janë shtrënguar gradualisht.

Por a do të vazhdojmë me frikën e asaj çka historia na servir, apo do ecim përpara për të bashkëjetuar me bekimin e "të mirave" të tokës së hirtë por me zemër të bardhë?!

BESA,

ky thesar i lashtë dhe unik për shqiptarët

Besa, ose kulti i fjalës së dhënë, lidhet në burim me mitin biblik të thënies “Në fillim ishte fjala”. Para se të ishte shkrimi, kontrata, njeriu, bota ishte vetë fjala. Ky kult madhështor, i cili në popujt euro-perëndimor pak nga pak mori karakterin e një idiome fetare kishtarë, te shqiptarët ruajti gjuhën e burimit.

Një ndër virtytet më të lashta të popullit shqiptar është edhe besa. Besa është një zotim solemn për të vepruar për një qëllim të përbashkët. Besa jepet nëpërmjet fjalës së nderit për të përkrahur dikë ose për t'u lidhur me të. Besa jepet për çështje personale, familjare, shoqërore, kombëtare.

Sipas traditës shqiptare në momentin kur jepet ky zotim, atëherë personi i cili është pjesë përbërëse e kësaj lidhjeje mund të sakrifikojë edhe jetën e tij për të përmbushur betimin.

Besa për çështje kombëtare është besa e cila është vlerësuar dhe është shkruar më shumë për të, edhe besa për çështje personale zë një vend të rëndësishëm në traditën shqiptare. P.sh. ruajtja e sekreteve të dikujt, është një formë bese që i jepet tjetrit, që ai informacion mos të merret vesh nga të tjerët. Gjithashtu edhe besa e lidhur mes familjeve për të ndërprerë gjakderdhjet dhe hakmarrjet është e një rëndësie të veçantë. Nëse ka ndodhur ndonjë konflikt mes ndonjë anëtarit të një familjeje dhe një familjeje tjetër, atëherë nëse familja e cila ka pasur të drejtë të marrë hakun, jep besën që fal gjakun, atëherë ajo familje duhej të qëndronte në fjalën e dhënë.

Besa në grupe apo shoqëri haset shumë herët në historinë shqiptare.

Besëlidhje të tilla si: Besëlidhja e Lezhës e vitit 1444, Besëlidhja e Kurveleshit e vitit 1547, Lidhja Shqiptare e Prizrenit më 1878, Kuvendet e mbajtur në vise të ndryshme shqiptare, Besëlidhja e vitit 1912 për shpalljen e pavarësisë, janë raste tipike të besës në grupe. Edhe në vargjet e shkruara nga Aleksandër Stavëri Drenova, të cilat sot këndohen në himnin kombëtar, në



fjalët e para hasim elemente të besës.

**“Rreth flamurit të përbashkuar
Me një dëshirë e një qëllim,
Të gjithë atij duke iu betuar
Të lidhim besën për shpëtim.”**

Edhe në thëniet popullore hasim në shumë fjalë të urta të cilat nxisin mbajtjen e besës, dhe eliminojnë elementet e tradhtisë. Në Lurë të Dibrës e përdorin një fjalë të këtillë: “Asht ma zort fjala e dhanme, se puna e bame”. Të mbash fjalën nevojitet sakrificë dhe një angazhim i cili shpeshherë ka kosto të larta. Fjala e dhënë ndonjëherë mund të na dëmtojë materialisht, fizikisht, shpirtërisht, kurse ndonjëherë mund ta paguajmë edhe me jetën personale. Po gjithsesi më mirë të humbasësh jetën në mbajtjen e fjalës së dhënë, sesa duke tradhtuar atë. Në vazhdim do të paraqesim disa thënie popullore të cilat kanë të bëjnë me besën, duke shënuar edhe vendin nga i cili kanë prejardhjen.

**“Besa asht ma e fortë se vdekja” – Krujë
“Arma ma e mirë e armikut është tradhtia” – Prizren
“Besa e burrit thyen edhe gurin” – Jug
“Detit i ka hije vala, burrit i ka hije fjala” – Vlorë
“Kah del fjala, del shpirti” – Shkodër
“Si të kesh besë, nuk je fukara” – Lurë-Dibër**

“Ylli, mbasi u ba bisht, filloi të pritet” – Sillovë, Dibër

Besa shqiptare është një virtut i lashtë ilir, i trashëguar brez pas brezi, edhe ndaj vështirësive, globalizimit kulturor dhe sprovave të ndryshme të moralit, ajo jeton edhe në ditët e sotme.

Besa shqiptare në kohë të ndryshme ishte edhe një lloj kushtetute apo ligji, pra aty ku mungonte shteti.

Çfarë thotë kanuni për besën?

Në analizën e Kanunit të Lekë Dukagjinit të mbledhur nga Shtjefën Gjeçovi, besa është e ndarë në gjini dhe forma të ndryshme. Aty besa përcaktohet si: “Sjellje besimtare me anë të së cilës gjithkush që ka nevojë që të shlyejë një borxh, duhet të japë një shenjë besimi, duke thirrur Zotin të dëshmojë për të vërtetën”.

Besa mund të bëhet vetëm përpara autoriteteve të njohura nga komuniteti duke bërë një betim solemn. Tre janë ritualet kryesore nëpërmjet të cilave shprehet fjala e dhënë: mbi gurin, mbi kryqin dhe Vangjelin, si dhe mbi kokën e djemve.

Deklarata bëhet sipas një rregulli të paracaktuar. Para së gjithave vendoset dita e mbledhjes së gjyqit të pleqve dhe përpara tyre do të vijë kush kërkon që të japë besën. Më pas vijnë deklaratat e gjykatësve dhe të afërmeve të tyre.

E drejta e besës bie mbi ata që të cilët kanë pësuar një fyerje. Nuk i lejohet të betohen atyre që kanë qenë dëshmitarë të krimit.

Besa në letërsinë dhe gojëdhënat shqiptare

Pa dyshim se fenomeni i besës është i pranishëm edhe në letërsinë shqiptare. Atë e gjejmë tek gojëdhënat, tek letërsia popullore, në folklor e romane. Për shembull, tek legjenda e Rozafatit.

Aty ku tregohet se për të respektuar besën heshtet edhe kur është fjala për njeriun e zemrës. Apo tek Doruntina dhe Konstadini, kur për ta mbajtur besën e dhënë nënës, Kostandini ngrihet edhe nga varri.

Në anën tjetër, edhe në shumë romane, siç është ‘Prilli i thyer’ i shkrimtarit Ismail Kadare flitet për rëndësinë e besës tek shqiptarët dhe për peshën e respektimit të saj. Sipas rregullave të shoqërisë shqiptare nëse dikush zotohet me fjalën “Ta jap besën” për çfarëdo çështje, atëherë mund t’i besoni përfundimisht.

T’i japësh “BESËN” diku, është t’i japësh një fjalë kaq të rëndësishme, e cila duhet mbajtur me çdo kusht. Jo shumë kohë më parë, kur një udhëtar kalonte nëpër zonat malore shqiptare, kalonte nga “BESA” në “BESË”, shoqërohej i pacenuar deri në destinacion.

Për një që nuk i njeh këto tradita është e vështirë ta kuptojë që, ai, i cili jepte këtë lloj premtimi, përgjigjej me jetën e tij. Mosmbajtja e fjalës së dhënë, do të thoshte tradhti e lartë, njësoj sikur ky “njeri” të mos meritonte të quhej i tillë.

Në kohërat moderne i kthehemi gjithnjë të kaluarës për të rigjetur vlerat, ato vlera të humbura të dashurisë e besnikërisë që sot bëhen gjithnjë e më të rralla në shumë

shoqëri në të gjitha kontinentet.

Nuk e di përse, por prej disa kohësh, më vjen në mendje një baladë shqiptare, kaq antike por edhe moderne në të njëjtën kohë. “BESA E KOSTANDINIT”.

Kjo legjendë e vjetër shqiptare, tregon se si bota dhe dashuria nuk i njihte kufijtë. Ku lufta merrte jetë njerëzish, ashtu siç ndodh edhe sot, shfaros familje të tëra, i bën të mërgojnë larg e të vuajnë nga malli për tokën e tyre.

Legjenda tregon se si për të mbajtur fjalën e dhënë, edhe të vdekurit ringjallen, kapërcejnë kufijtë e të pamundurës për të bërë të mundur atë që shumë njerëz të kohëve moderne nuk janë në gjendje të mbajnë. Duhet kujtuar se vetëm dashuria mund të ushqejë pagën e paqja të bëjë të jetojë dashurinë. Atëherë, përse të mos duhemi mes qeniesh njerëzore?!!

Të huajt për besën: “Nuk ka nevojë për marrëveshje të shkruara me shqiptarët”

Fenomeni i besës tek shqiptarët u ka bërë gjithmonë përshtypje të huajve dhe vizitorëve. Ata kanë qenë të mahnitur nga fuqia e këtij zotimi ndërmjet shqiptarët. Nga respektimi i këtij kodi sikurse ai të ishte ligj i shkruar.

Shumë studiues të huaj shkruajnë se si standardi etik i shqiptarëve është besa, pra, fjala e dhënë. Ata tregojnë se si pavarësisht nga rrethanat, kur një shqiptar jep fjalën, ajo nuk mund të shkelet dhe nuk ka nevojë për asnjë lloj marrëveshjeje të shkruar. Si pasojë, kuptimi i fjalës “i pabesë” është shkelja e fjalës së dhënë.

Në një varg hartash tregtare shoqëruar me tekst, të botuara më 1886 nga ministria franceze e Tregtisë, fashikulli kushtuar Shqipërisë i njofton eksportuesit se nuk ka nevojë për marrëveshje të shkruara për shqiptarët. “Sipas tyre fjala e tyre e thënë ka mjaft peshë dhe nuk njihet asnjë rast që ta kenë shkelur”. Henri N. Breilsford, në librin e tij të njohur për Maqedoninë, ka këtë anekdotë: “Gjëja më kuptimplotë nga të gjitha ishte pyetja lakonike me të cilën iu përgjigj kërkesës sime një peshkop bullgar. “A i besoni atij?” – e pyeta unë. – “Ai është shqiptar. Apo nuk është?” – ishte përgjigjja. Për shekuj me radhë sllavët dhe shqiptarët kanë qenë në armiqësi të pandërprerë për vdekje. Dhe ja, ky është komenti i një armiku për karakterin e tjetrit”.





Historia njëshekullore me botën e kombeve të lira

Data 28 korrik 2022, shënon 100-vjetorin e njohjes së Shqipërisë nga SHBA-të dhe vendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Marrëdhëniet këto që pas atij lulëzimi do të pësonin edhe “goditjen” më të rëndë, me ardhjen e komunistëve pas Luftës së Dytë Botërore, me ardhjen e Enver Hoxhës, marrëdhëniet diplomatike me Shtetet e Bashkuara u ndërprejnë prej 45 vitesh, si rezultat i vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri, ku do të ishte ardhja e demokracisë, ajo që do të shënonte edhe me hapjen e Ambasadës Amerikane në Tiranë, më 1 tetor 1991, edhe ri-vendosjen e marrëdhënieve të shkëlqyera.

Ish-Sekretari i Shtetit, James Becker, do të ishte zyrtari i parë i nivelit të lartë i SHBA-ve, që do të

vizitonte Shqipërinë, pas periudhës së gjatë të izolimit dhe që do të përcillte mesazhin aq të ëndërruar prej shqiptarëve: “Mirë se vini në botën e kombeve të lira”.

Marrëdhëniet midis vendeve tona datojnë në fillimet e shekullit të kaluar, në kohën kur Mbreti i shqiptarëve, Zogu i Parë, dhe Presidenti i SHBA-ve Woodrow Wilson, të cilit Shqipëria i dedikon jo pak, por ekzistencën e saj. Një gjest i rëndësishëm ky në Konferencën e Paqes, në Londër, i cili nuk u harrua kurrë nga mijëra amerikanët me origjinë shqiptare, të cilët mbajtën kontaktet me atdheun e tyre përgjatë gjithë këtyre viteve.

Nuk mund të lemë pa përmendur kontributin e Presidentit Bush, i cili udhëhoqi rrëzimin e “Perdes së Hekurt” dhe vendosjen e demokracisë në vendet ish-komuniste, një prej të cilave ishte dhe Shqipëria, rolin e

padiskutueshëm të Presidentit Clinton, të zonjës së madhe Albright, që çuan në ndërhyrjen ushtarake të NATO-s në Kosovë, dhe rrugën që ndoqi administrata Obama, që e kristalizuan më tej provën e miqësisë së thellë shqiptaro-amerikane. Për herë të parë në historinë mijërvjeçare të kombit tonë, superfuqia e botës dhe vendet më të fuqishme europiane, anëtare të NATO-s, u radhitën përkrah popullit shqiptar në dy anët e kufirit, duke e shpëtuar atë nga një kasaphanë që nuk njihte kufij.

Marrëdhëniet diplomatike mes Shqipërisë dhe SHBA-së e kanë pikënisjen më 28 korrik të vitit 1922, kur ende shteti shqiptar sapo kishte ri-konfirmuar pavarësinë.

Vendimi për lidhjen e marrëdhënieve diplomatike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka ardhur natyrshëm pas vetos që presidenti

100-vjetori i vendosjes së marrëdhënieve mes Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë

Ambasadorja Yuri Kim është shprehur krenare për Shqipërinë në eventin e organizuar për kremtimin e 100-vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve me Shtetet e Bashkuara. Gjatë fjalës së saj, Kim theksoi se SHBA nuk është lëkundur asnjëherë në besimin e saj tek Shqipëria. "Ishte një pishtar që nuk u lejua kurrë të shuhej. Ndërsa shënojmë një shekull marrëdhënie, duhet të vlerësojmë veçanërisht ata shqiptarë që paguan duke dhënë jetën e tyre. E pandryshuar mbetet, SHBA-të kurrë nuk janë lëkundur nga besimi në një Shqipëri të pavarur dhe sovranë. Ne kurrë nuk jemi lëkundur në besimin që kemi në miqësinë tonë. Ne ishim krenarë kur ju mbështetëm kur ju u shkëputet nga zinxhirët e regjimit. Krenar që u anëtarësua në NATO. Sërish krenar që të festojmë me ju që ju filluat zyrtarisht negociatat me BE-në. SHBA-të nuk janë lëkundur kurrë, për sovranitet", - deklaroi ambasadorja Kim.



Ish-presidenti amerikan George W. Bush nëpërmjet ambasadores Yuri Kim ka përcjellë mesazhin e tij për vendosjen e 100-vjetorit të marrëdhënieve të Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë. "Unë dhe Laura ju dërgojmë përhëndetjet më të ngrohta. Ky gur kilometrik është dëshmi e miqësisë. Në vitin 2007 isha krenar që isha presidenti që vizitova Shqipërinë. U bëra dëshmitari mikpritjes tuaj të sinqertë. Jam i lumtur të shoh Shqipërinë dhe SHBA-të si aleatë. Shpirti shqiptar që kurrë nuk rresht për liri dhe tradita juaj e besës janë vlera. Gëzuar të gjithëve 100-vjetorin", - ka shkruar në letrën e tij ish-presidenti amerikan.

amerikan Thomas Woodrow Wilson vuri në konferencën e Paqes në Paris duke i rikthyer pavarësinë Shqipërisë.

Presidenti pasardhës i Wilson-it, Warren Harding, emëroi si ambasador të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, Ulysses Grant Smith, i cili e nisi misionin diplomatik më 4 Dhjetor 1922. Një diplomat që jo thjesht vuri gurin e parë kilometrik në një rrugë të gjatë të marrëdhënieve, por që ishte njëkohësisht i pari që ndiçoi shtetin amerikan se çfarë ishte Shqipëria çfarë ishin shqiptarët dhe si mund ta ndihmonte Amerika Shqipërinë.

"Ky vend është shumë i varfër, njerëzit në përgjithësi janë të pashkolluar dhe të paushqyer, por çuditërisht përpara meje ndodhet kryeministri Fan Noli, i cili flet një anglishte harvardiane shumë më të mirë nga mua. Dhe unë ndjem keq përpara tij", - shkruan Smith në kujtimet për punën si ambasador në vendin tonë.

Deri në vitin 1939 Shqipëria ishte thjesht një komb i preferuar për SHBA-në aq sa dhjetëra amerikanë vërshuan në vendin tonë jo vetëm si diplomatë, por edhe si biznesmenë, themeluesë shkollash e deri në investitorë ekspeditash për të zbuluar

pasuritë e nëntokës sonë.

Kjo do të vazhdonte deri në vitin 1939 kur Shqipëria e humbi pavarësinë e saj pas pushtimit të vendit nga Italia dhe largimit të Mbretit Zog me familjen nga vendi.

Ambasadori amerikan në atë kohë në Tiranë, Hugh Grant, i ofroi tre pasaporta amerikane Zogut: një për vete, një për mbretëreshën Geraldinë dhe një për Lekën e sapolindur, të cilat u refuzuan nga ai.

Ambasada amerikane në Tiranë, u mbyll zyrtarisht më 16 shtator 1939, ndërsa diplomati Grant u largua më 27 Shtator.

Me ardhjen e komunistëve në

pushtet, për 52 vjet asnjë diplomat amerikan dhe shqiptar nuk vuri këmbë në Shqipëri dhe në SHBA.

Vetëm 3 muaj pasi ishte rihapur ambasada, më 21 qershor 1991, Sekretari Amerikan i Shtetit, James Baker, do të vizitonte Tiranën. Me mijëra shqiptarë mbushën sheshin "Skënderbej", duke i rezervuar atij një pritje madhështore, e ngulitur në memorien e të gjithëve.

Marrëdhëniet shqiptaro-amerikane do ta shënonin kulmin e tyre me vizitën historike të Presidentit George W. Bush, më 10 Qershor 2007, e para e një presidenti amerikan në Shqipëri. Pamjet e qytetarëve të Fushë-Krujës duke u shtyrë për të përqaftuar presidentin Bush, i cili përballë entuziazmit të qytetarëve theu rregullat e sigurisë, do të ktheheshin në lajmin kryesor të televizioneve amerikane.

Në kuadrin e këtyre marrëdhënieve duhet theksuar se ka qenë qëndrimi i vendosur dhe angazhimi i Presidentit Bush dhe gjithë administratës që ai drejtoi, që zgjidhja e statusit të Kosovës të mos shtyhet pafundësisht dhe që Kosova të fitojë pavarësinë. Dhe kjo kulmoi në vizitën e parë të tij, kur nga Tirana Presidenti në detyrë George W. Bush deklaroi se Kosova do të jetë e pavarur, dhe kështu ndodhi, më 17 Shkurt 2008, Kosova shpalli pavarësinë e saj nga Serbia, dhe ishin Shtetet e Bashkuara që u radhitën ndër shtet e para që e njohën pavarësinë e Kosovës.

Marrëdhëniet bilaterale të Shqipërisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, konsiderohen të rëndësishme parësore për politikën e jashtme të Shqipërisë.

Një vlerësim i mirënjohjes së kombit shqiptar për rolin e rëndësishëm që SHBA-të, kanë luajtur që nga njohja e shtetit shqiptar e deri në ditët e sotme, inkurajim për të vazhduar kursin e nisur të reformave, falënderim për kontributin e vendit tonë në luftën kundër terrorizmit, mbështetje për përpjekjet tona për integrimin në NATO, konfirmim i rolit të pazëvendësueshëm të SHBA-së në zgjidhjen e statusit të Kosovës. Prej nga dita e parë e këtyre lidhjeve, që zënë fill në kohën e Mbretërisë Shqiptare, Mbretit Zog I, e cila që e para ajo që gjeti mikun e saj të përjetshëm e deri më sot, ishin ambasadorët amerikanë ata që e çuan deri në zenit, lidhjen mes SHBA-së dhe Shqipërisë. Ata ishin: Ulysses Grant-Smith (Ministër 1922-25), Charles C. Hart (Ministër 1925-29), Herman Bernstein (Ministër 1930-33), Post Wheeler (Ministër 1933-34), Hugh Gladney Grant (Ministër 1935-39), William Edwin Ryerson (Ambasador 1991-94), Joseph Edward Lake (Ambasador 1994-96), Marisa R. Lino (Ambasadore 1996-99), Joseph Limprecht (Ambasador 1999-2002), James Jeffrey, Marcie Rice, John Wither, Alexander Arvizu, dhe ambasadorja në detyrë, Yuri Kim.

Konsujt amerikanë në Vlorë dhe Tiranë

Vlorë: Joseph E. Haven (Konsull 1919); Tiranë: George C. Minor (Zëvendës Konsull 1927-29), Royal R. Jordan (Zëvendës Konsull 1929), Paul H. Demille (Zëvendës Konsull 1931-32), Erich W. A. Hoffmann (Zëvendës Konsull 1932-38), Robert L. Hunter (Zëvendës Konsull 1938), Morris N. Hughes (Konsull 1938).

Lista e Ambasadorëve në Shqipëri

YURI KIM

Yuri Kim mbërriti në Tiranë si Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Republikën e Shqipërisë në janar 2020. Ambasadorja Kim, një diplomate karriere, ka punuar mbi sfida kyçe të politikës së jashtme dhe sigurisë kombëtare në mbarë Europën, Azinë dhe Lindjen e Mesme. Ka qenë drejtoreshë e Çështjeve të Europës Jugore dhe ka mbuluar Turqinë, Greqinë, Qipron dhe më gjerë rajonin e Mesdheut Lindor; si drejtoreshë e Zyrës së Çështjeve Europiane të Sigurisë dhe ato Politiko-Ushtarake, ka mbuluar NATO-n dhe Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE). Më parë ka qenë Shefe e Kabinetit e Zëvendës Sekretarit të Shtetit dhe drejtoreshë e Qendrës për Studimin e Administrimit të Diplomacisë. Më herët në karrierën e saj ka qenë Ndihmëse e Posaçme e Sekretarit të Shtetit Colin Powell, si dhe Ndihmëse e Posaçme e Ndihmës Sekretarit të Shtetit për Çështjet e Azisë Lindore dhe Paqësorit. Mandatet e saj jashtë SHBA-ve përfshijnë Turqinë, Irakun, Republikën e Koresë, Japoninë dhe Kinën. Yuri Kim ka një diplomë Bachelor nga Universiteti i Pensilvanisë dhe një Master në Filozofi nga Universiteti i Kembrixhit.



ALEXANDER ARVIZU

Alexander Arvizu, ka qenë ambasadori më jetëgjatë i Shteteve të Bashkuara në Tiranë. Alexander A. Arvizu një diplomat i SHBA-ve, i cili shërbeu si ambasador amerikan në Shqipëri, lindi në bazën e ushtrisë amerikane në Japoni. Babai i tij është me origjinë nga Dolores Hidalgo, Meksikë dhe e ëma ishte nga Kyoto, Japoni. Në vitin 1980 ai u diplomua në Universitetin e Georgetown. Ai ka studiuar gjuhë të ndryshme aziatike si gjuhën japoneze, koreane, thai dhe khmer.



JOHN L. WITHERS II

Shteti i Rezidencës: Maryland. Zyrtar i Shërbimit të Huaj, Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe i Plotfuqishëm, i emëruar më 28 Korrik, 2007. Prezantimi i letrave kredenciale: 25 Gusht 2007

Përfundimi i Misionit 18 Gusht, 2010.



MARCIE B. RIES

Shteti i Rezidencës: Distrikti i Kolumbia-s. Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe i Plotfuqishëm i emëruar më 18 Tetor, 2004. Prezantimi i letrave kredenciale: 30 Tetor, 2004.



JAMES F. JEFFREY

Shteti i Rezidencës: Virxhinia. Zyrtar i Shërbimit të Huaj. Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe i Plotfuqishëm i emëruar më 3 tetor 2002. Prezantimi i letrave kredenciale: 22 tetor, 2002. Përfundimi i Misionit: më 2 maj, 2004.



JOSEPH LIMPRECHT

Shteti i Rezidencës: Virxhinia. Zyrtar i Shërbimit të Huaj. Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe i Plotfuqishëm i emëruar më 7 korrik, 1999. Prezantimi i letrave kredenciale 8 shtator, 1999. Përfundimi i Misionit: Ka vdekur në veri të Shqipërisë, 19 maj, 2002.



MARISA R. LINO

Shteti i Rezidencës: Oregon. Zyrtare e Shërbimit të Huaj. Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe i Plotfuqishëm i emëruar më 2 korrik 1996.

Prezantimi i letrave kredenciale: 4 shtator, 1996. Përfundimi i Misionit: më 20 maj, 1999.



JOSEPH E. LAKE

Shteti i Rezidencës: Teksas. Zyrtar i Shërbimit të Huaj. Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe i Plotfuqishëm i emëruar më 5 korrik 1994. Prezantimi i letrave kredenciale: 17 tetor, 1994. Përfundimi i Misionit: më 15 mars, 1996.



WILLIAM E. RYERSON

Shteti i Rezidencës: Virxhinia. Zyrtar i Shërbimit të Huaj. Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe i Plotfuqishëm i emëruar më 2 dhjetor 1991. Prezantimi i letrave kredenciale: 21 dhjetor 1991. Përfundimi i Misionit: më 13 tetor, 1994. Shtetet e Bashkuara rifilluan marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë më 15 mars 1991. Ambasada në Tiranë u hap më 1 Tetor 1991 me Kristofer Hill si i Ngarkuar



me Punë.

HUGH G. GRANT

Shteti i Rezidencës: Alabama. I emëruar jo karrierë. I Dërguar i Jashtëzakonshëm dhe Ministër i Plotfuqishëm. I emëruar më 9 gusht 1935. Prezantimi i letrave kredenciale 8 nëntor 1935. Përfundimi i Misionit: Forcat Italiane pushtuan Tiranën më 8 prill, 1939. Legata në Tiranë u mbyll zyrtarisht më 16 shtator 1939, Grant u largua më 27 shtator 1939.



POST WHEELER

Shteti i Rezidencës: Washington. Zyrtar i Shërbimit të Huaj. I Dërguar i Jashtëzakonshëm dhe Ministër i Plotfuqishëm, i emëruar më 26 gusht 1933.

Prezantimi i letrave kredenciale: më 28 nëntor 1933. Përfundimi i Misionit: U largua më 1 nëntor 1934.



HERMAN BERNSTEIN

Shteti i rezidencës: Nju Jork. I emëruar jo karrierë. I Dërguar i Jashtëzakonshëm dhe Ministër i Plotfuqishëm,

i emëruar më 17 shkurt 1930. Prezantimi i letrave kredenciale: më 28 prill 1930. Përfundimi i Misionit: U largua më 24 shtator 1933.



CHARLES C. HART

Shteti i Rezidencës: Rrethi i Kolumbia. I emëruar jo karrierë: I Dërguar i Jashtëzakonshëm dhe Ministër i Plotfuqishëm, i emëruar më 27 maj 1925. Prezantimi i letrave kredenciale: 1 gusht 1925.

Përfundimi i Misionit: Ri-akredituar kur Shqipëria u shpall një mbretëri. Prezantoi letra të reja kredenciale më 13 dhjetor 1928. La postin më 12 dhjetor 1929.



ULYSSES GRANT-SMITH

Shteti i Rezidencës: Pensilvania. Zyrtar i Shërbimit të Huaj. I Dërguar i Jashtëzakonshëm dhe Ministër i Plotfuqishëm, i emëruar më 22 shtator 1922. Prezantimi i letrave kredenciale: 4 dhjetor 1922. Përfundimi i Misionit: U largua më 8 shkurt 1925.





LUIZA GEGA BËN HISTORI, E PESTA NË BOTË

Luiza Gega nuk njeh më limite me rezultatet e saj. 34-vjeçarja, përfaqësuese e Forcave të Armatosura, siguroi rezultatin më të mirë në historinë e atletikës shqiptare. Ajo u rendit e pesta në botë në garën e 3 mijë metrave me pengesa në Botërorin e Atletikës u zhvilluan në Oregon të SHBA-së. Gega përmirësoi edhe rekordin kombëtar në këtë garë, duke kapur kohën 9.10.04. Deri më tani Gega rezultatin më të mirë e kishte po në botëror, në vendin e 8. Gara e radhës ku ajo bashkë me trajnerin Taulant Stërmasi do të kërkojnë mrekullinë e radhës është europiani i Mynihut në Gjermani.